# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 11/95**
**Datë: 26.03.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria – Vlada - Government***

***Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology***

**Agjencia e Kosovës për Akreditim**

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

# Koncept dokument për Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Përgatitur nga:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT)

Departamenti i arsimit të lartë dhe shkencës

Departamenti për integrime evropiane

Departamenti ligjor në MASHT

Divizioni i financave në MASHT

Agjencia e Akreditimit të Kosovës

Ministria e Financave

Zyra e Kryeministrit

Përfaqësues nga shoqëria civile

Përfaqësues nga USAID

Përfaqësues nga Projekti HERAS

Përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës

Përmbajtja

Përmbledhje e konceptdokumentit ..... 4

Hyrje ..... 10

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ..... 12

Kapitulli 2: Objektivat ..... 25

Kapitulli 3: Opsionet ..... 27

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim ..... 28

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit ..... 28

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument] ..... 39

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ..... 40

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ..... 46

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ..... 46

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ..... 47

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ..... 48

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ..... 56

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ..... 58

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ..... 59

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ..... 61

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore ..... 65

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ..... 69

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ..... 70

Përmbledhje e konceptdokumentit

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| Titulli | Konceptdokument për Agjencinë e Kosovës për Akreditim |
| Ministria bartëse | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| Personi kontaktues | Fehmi Hysenaj, kryesues i grupit punues për AKA- +383 38 20020077<br>Avni Gashi- u.d. i drejtorit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim- 038 213 722<br>Shpresa Mehmeti, zyrtare në DALSH/MASHT, personi kontaktues për konsultim publik |
| PVPQ | Parashihet me planin e punës së MASHT për vitin 2019 dhe PSAK |
| Prioriteti strategjik | Krijimi i kornizës ligjore specifike për AKA-në me qëllim që të sigurohet pavarësia e plotë e funksionimit të Agjencionit<br>PSAK 2017-2021 |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Paqëndrueshmëri institucionale e AKA në raport me detyrat dhe përgjegjesitë për realizimin e misionit të saj dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë si dhe nevoja për rregullimin normativ të fushës së institucionit për akreditimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës |
| Përmbledhje e konsultimeve | Në këtë fazë të hartimit të KD kemi pasur konsultime me përfaqësuesin e Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesin e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare të cilët janë edhe anëtarë të Komisionit për hartimin e KD.<br>Gjatë diskutimit paraprak dhe publik do ti konsultojmë edhe ministritë, institucionet e arsimit të lartë dhe akterë të tjerë që merren me këtë fushë. |

| | |
|---|---|
| | |
| | |
| Opsioni i propozuar | Opsioni i dytë:<br><br>Rregullimi me ligj të veçantë për funksionimin e AKA-së, është mënyra më e mirë e sigurimit të pavarësisë së plotë të AKA-së, krijimit të stabilitetit juridik (duke shmangur mundësinë që në vazhdimësi të ndryshohen UA për Akreditim), dhe aprovimin e strukturës së re funksionale të AKA-së. Bazuar në parimin e drejtësisë, që ligji i veçantë e përjashton ligjin e përgjithshëm, me rregullimin e kësaj çështje me ligj të veçantë, do te vendoseshin kriteret dhe procedurat të cilat do ti lejonin AKA-së që shumë probleme me të cilat është përballë AKA deri më tani në punën e vet, t'i jepen zgjidhjet meritore me ligj të veçantë, siç është çështja e stafit të cilët nuk janë shtetas të Kosovës, etj. Praktikisht për të siguruar pavarësi, stabilitet dhe profesionalizëm, çështja e AKA-së do të duhej të rregullohej me ligj të veçantë, me ç'rast do të sigurohet ngritja e cilësisë.<br><br>Buxheti total për 5 vite për zbatimin e KD është 5, 910,240.91 euro. |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim). Ky opsion i këtij Konceptdokumenti nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës. Çdo aktivitet që lidhet me zbatimin e këtij legjislacioni është planifikuar në projeksionet buxhetore të MASHT-it, pasi vazhdohet me gjendjen aktuale, opsioni i propozuar mbulohet nga ndarjet e buxhetit në shumë prej €552,318 brenda kufirit aktual të MASHT-it.<br><br>Opsioni 2: Ndryshimi i qasjes ekzistuese nga gjendja aktuale në opsionin e dytë do të ketë implikime shtesë në Buxhetin e Kosovës. Për tu implementuar ky konceptdokument (pas hyrjes në fuqi të ligjit për AKA-n) kushton në shumë prej 5,910,241 € (për pesë vite 2019-2023), ndërsa ndarja e mjeteve buxhetore për këtë konceptdokument është në shumë prej 2,839,930 € për vitet 2019 -2023, ndërsa kosto shtesë për implementimin e këtij konceptdokumenti është në shumën prej 3,380,742.81 € për periudhën 2019-2023, mjete të cilat nuk janë të planifikuara në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe draftbuxhetin 2019 dhe vlerësimet buxhetore 2020-2023 në MASHT.<br><br>Sipas analizave buxhetore opsioni i dytë ka implikime shtesë në buxhetin e Republikës së Kosovës në shumë prej 3,070,311 € për periudhën 2019-2023 (për vitin 2019 kostoja shtesë është në shumë prej 840,786 €, për vitin 2020 kostoja shtesë është në shumë prej 834,822 € për vitin 2021 kostoja shtesë është në shumë prej 408,232 € për vitin 2022, dhe për vitin 2023 kostoja shtesë është në |

| | |
|---|---|
| | shumë prej 419,396 €). Kjo kosto shtesë nuk është e planifikuar në draftbuxhetin e vitit 2019 dhe vlerësimet buxhetore për vitet 2020-2023 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.<br><br>Opsioni 3: Ndryshimi i politikës ekzistuese (të bëhet diçka), ky opsion ka kosto shtesë në Buxhetin e Kosovës për vitin 2019-2021 në shumë prej 86,274 euro, për hartim të bazës ligjore dhe zhvillimin e aktiviteteve që lidhet me zbatimin e këtij konceptdokumenti e të cilat mjete nuk janë të planifikuara në draftbuxhetin e vitit 2019 dhe vlerësimet 2020-2021 në MASHT.<br><br>Ndryshimi i qasjes së zbatimit të legjislacionit aktual mes akterëve si AKA, MASHT, dhe gjithë të tjerëve, apo edhe rritja e numrit të stafit duke kërkuar nga Qeveria/Ministria e Financave dhe Administratës publike në kuptimin që do të forcoheshin burimet njerëzore në AKA dhe ngritja e buxhetit, por edhe kjo prap nuk eshte opcion i mjaftueshem për adresimin e problemeve sepse nuk siguron qëllimin kryesor të pavarësisë së AKA. Andaj rekomandohet opcioni 2 për nxjerrjen e ligjit për AKA ku siq kemi cekur edhe nga problemet e mësiperme ku ndryshimi i shpeshtë i akteve nënligjore na sjell vështirësi implementuese të politikave. Gjithashtu shkakton konfuzitet tek IAL nxjerrja e akteve dhe plotësim ndryshimeve në raport me kërksat e akreditimit dhe zbatimit të këtyre akteve. |
| Ndikimet ekonomike | Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, prandaj është një sfidë por edhe mundësi e vërtetë për AL-të për të siguruar arsim cilësor dhe për përgatitjen e brezave të rinjë për tregun e punës që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve pika 1.2. dhe 1.2.1 Fushat prioritare në KASH-in 2019-2021. Prioritetet janë paraqitur në mënyrë specifike dhe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim, duke i kushtuar vëmendje gjithashtu masave të paraqitura në Programin për Reforma në Ekonomi 2018-2020, si dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Prioritetet më poshtë gjithashtu bazohen në dokumente të tjera strategjike sektoriale, duke iu mundësuar organizatave buxhetore një masë të fleksibilitetit për të përcaktuar strukturën më të përshtatshme dhe nivelet më adekuate të financimit për të arritur këto qëllime. Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2019 me parashikimet për periudhën afatmesme (2019-2021), nga organizatat buxhetore pritet të tregojnë se si plani i tyre buxhetor u përgjigjet prioriteteve të Qeverisë të paraqitura më poshtë. Kundrejt prioriteteve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.<br><br>**Ndërsa pika 1.2. 1. Arsimi:** ***Cilësia dhe konkurrueshmëria e arsimit të lartë*** synohet të rritet përmes plotësimit të kornizës ligjore për arsimin e lartë, si dhe plotësimin e akreditimit me një proces të rangimit të programeve dhe |

| | |
|---|---|
| | institucioneve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, raportim më kuptimplotë për universitetet si dhe do të ofrojë informata objektive për punëdhënësit dhe kështu përmirëson edhe punësueshmërinë e të rinjve. Përveç kësaj, Qeveria është e përkushtuar drejt funksionalizimit të plotë të sistemit të menaxhimit të informatave në arsimin e lartë (SMIAL), i cili së bashku me zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve të tjera të informatave do të mundësojë përdorimin e të dhënave të këtij sistemi për të siguruar që programet e studimit në arsimin e lartë janë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Financimi për programet e arsimit të lartë dhe ato të arsimit profesional do të rritet nëpërmjet rishikimit të formulës aktuale të financimit dhe duke i riorientuar shpenzimet nga fushat më pak prioritare në ato më prioritare. Në fund, sa i përket lidhjes së punës hulumtuese në IAL-te me industrinë përmes qasjes në specializimin e mençur dhe investimeve në hulumtim dhe zhvillim, fokusi kryesor do të jetë përmirësimi i kornizës ligjore për transferimin e inovacionit dhe teknologjisë, si dhe financimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore.<br><br>Me kryerjen e procedurave te akreditimit AARK ndikon edhe në ekonominë e vendit sepse institucionet e akredituara përpos që punësojnë një numër të madh të qytetarëve, po ashtu sjellin dhe pajisje dhe mjete të teknologjisë së fundit që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. |
| Ndikimet shoqërore | Avancimi i kornizës ligjore në lidhje me akreditimin e programeve studimore universitare ka ndikime të shumta. Kosova ka numër të madh të institucioneve të arsimit të lartë -32 institucione, shumica e të cilave janë kolegje. Së bashku, të gjitha institucionet e arsimit të lartë ofrojnë 358 programe studimi, duke përfshirë tri ciklet e studimit sipas Bolonjës. Në këto institucione janë të regjistruar rreth 140.000 studentë. Ndikimet janë shoqërore dhe individuale dhe përkojnë me zhvillimin e 'kapitalit njerëzor'. Njohja, shkathtësitë dhe gjykimi që farkëtohet përmes arsimit gjejnë shprehje në profesione dhe vende të punës, por edhe në jetën e përditshme. Marrë në përgjithësi, ndikimet shoqërore mund t'i referohen këtyre dimensioneve. Së pari, avancimi i kornizës ligjore në akreditim ka ndikim të drejtpërdrejtë në proceset e Evropianizimit të Kosovës sepse ofron perspektiva për një arsim cilësor, të krahasueshëm dhe kompatibil me arsimin dhe diplomat e fituara në Kosovë, me ato në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Ruajtja e statusit anëtar të AKA në Asociacionin Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsim të Lartë-ENQA dhe rikthimi i agjencisë në mekanizmat tjerë ndërkombëtar, siç është EQAR, rrit besueshmërinë në institucion dhe transparencën në vendimmarrje. Ky rikthim do i kontribuonte ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Kosovë, shtimit të mobiliteti akademik dhe njohjes së diplomave të arsimit të lartë të Kosovës në Evropë dhe më gjerë - Konventa e Lisbonës për Njohje https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/- |

| | |
|---|---|
| | /conventions/rms/090000168007f2c7 ).<br><br>Së dyti, ndikimet shoqërore ndërlidhen me përfitimet ekonomike. Arsimi cilësor mundëson punësim dhe si rezultat një shoqëri me arsim cilësor ka shkallë të ulët të papunësisë dhe varfërisë. Arsimi cilësor mund të rezultojë në shkallë më të lartë të inovacionit, prodhimit dhe aplikimit të teknologjive të reja, si parakusht për rritje ekonomike. Po ashtu, ndikimi shoqëror ka të bëjë me mobilitetin akademik dhe 'qarkullimin e trurit' si vendndodhje të një procesi dinamik në ndërtimin e dijes dhe inovacionit përgjatë sektorit publik dhe privat.<br><br>Së fundi, përfitimet shoqërore i referohen potencialit për zhvillim të një qytetarie aktive për të mirën publike, respektim të të drejtave të njeriut dhe mundësi të barabarta në zhvillim akademik dhe profesional në arsimin e lartë.<br><br>Me miratimin e KD dhe pastaj aktit juridik me të cilin do funksionalizohet AKA do të ketë ndikime shoqërore sepse me këtë rast do krijohej një pavarësi juridike e këtij institucioni, e cila do ta mbante larg ndikimeve politike dhe se shoqëria do realizonte të drejta në kushte të barabarta në këtë institucion pa ndikime nga jashtë. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori. |
| Ndikimet ndërsektoriale | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori. |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Bazuar në nenin 31, pika 3 e UA për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28.09.2018), institucionet e arsimit të lartë obligohen që ti kryejnë obligimet e tyre financiare për marrje të akreditimit në shumat si në vijim:<br><br>1. Akreditimi fillestar institucional................................. 3 000 €<br>2. Riakreditimi institucional ........................................... 2 000 €<br>3. Akreditimi i programit të studimit ........................... 1 000 €<br>4. Riakreditimi i programit të studimit ........................... 500 €<br>5. Pagesa për një vlerësues të jashtëm (ekspert).......... 3 300 €<br>6. Pagesa për një vlerësues të jashtëm (student) ........ 2 400 €<br><br>Taksat administrative duhet të përmbushen sipas ciklit të akreditimit/riakredtimit në bazë të udhëzimit administrativ 15/2018 dt.28.09.2018. |
| Testi i NVM-ve | Nuk është bërë testi i NVM për shkak se nuk ka ndikim direkt përveç që ndërlidhja bëhet përmes programeve të akredituara të cilat lidhen me tregun e punës dhe kompetencat e studentëve. |

| | |
|---|---|
| | Gjatë procesit të konsultimeve do të shohim ndikimet që mund të rrjedhin. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda një viti pas miratimit të këtij konceptdokumenti janë:<br>- Hartimi i Ligjit<br>- Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit<br>- Hartimi standardeve për procesin e monitorimit<br>- Informimi i IAL me legjislacionin e ri<br>- Kompletimi i stafit të AKA |
| Afatmesëm | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda dy deri pesë viteve pas miratimit të konceptdokumentit do të jenë:<br>1. Miratimi i Legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë.<br>2. Harmonizimi i akteve të IAL me legjislacionin në fuqi.<br>3. Hartimi i dokumentacionit që mbulon këtë fushë.<br>4. Akreditimi i IAL bazuar në Legjislacionin e ri.<br>5. Anëtarësimi në Organizatat përkatëse ndërkombëtare. |

# Hyrje

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për konceptdokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Konceptdokument për Agjencinë e Kosovës për akreditim |
| Ministria bartëse | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| Personi kontaktues | Fehmi Hysenaj- kryesues i grupit punues për hartimin e KD<br>Avni Gashi-u.d.i drejtorit në AKA<br>Shpresa Mehmeti, pikë kontakti për konsultime publike : 038 38 211923 |
| PVPQ | Parashihet me planin e punës së MASHT për vitin 2019 dhe PSAK |
| Prioriteti strategjik | Krijimi i kornizës ligjore specifike për AKA-në me qëllim që të sigurohet pavarësia e plotë e funksionimit të Agjencionit<br>Plani strategjik për arsim (PSAK 2017-2022) |
| Grupi punues | Fehmi Hysenaj- këshilltar në Kabinetin e Ministrit, kryesues i grupit për hartim<br>Gazmend Luboteni- përfaqësues, Këshilli shtetëror për cilësi në AKA<br>Vjollca Krasniqi- përfaqësuese, Këshilli shtetëror për cilësi në AKA<br>Rozafa Koliqi Lila- përfaqësuese , Këshilli shtetëror për cilësi në AKA<br>Avni Gashi, përfaqësues, AKA<br>Elmi Kelmendi- përfaqësues, zyra ligjore në AKA<br>Flamur Hyseni, Universiteti i Prishtinës<br>Drita Kadriu- përfaqësuese, Departamenti i arsimit të lartë dhe shkencës në MASHT<br>Bekim Samadraxha- përfaqësues, Divizioni për menaxhim, standarde dhe sigurim të cilësisë në arsimin e lartë<br>Mevlide Shamolli- përfaqësuese, Ministria e Financave |

| | |
|---|---|
| | Ferit Idrizi, përfaqësues, Departamenti për integrime evropiane, koordinim të politikave dhe çështjeve ligjore<br><br>Isni Kryeziu, përfaqësues, zyra ligjore në MASHT<br><br>Fehmi Zylfiu, përfaqësues, zyra e financave në MASHT<br><br>Mirlinda Lushtaku, përfaqësuese, ZKM<br><br>Qamile Sinanaj, përfaqësuese, Divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar në arsim të lartë dhe shkencë, MASHT<br><br>Shpresa Mehmeti, përfaqësuese, Divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar në arsim të lartë dhe shkencë, MASHT<br><br>Rron Gjinovci, përfaqësues nga shoqëria civile<br><br>Merita Teliqi, përfaqësuese nga USAID<br><br>Aqim Emurli- përfaqësues nga Projekti HERAS |
| Informata shtesë | Rekomandimet e organizatave ndërkombëtare si EQAR dhe ENQA, CEENQA, janë një ndër kushtet kryesore për rishikim dhe hartim të legjislacionit<br><br>Rekomandimet e Kuvendit/Legjislatura VI, Sesioni pranveror dt. 07.03.2018<br><br>Rekomandimi i Kuvendit pika 7: Kuvendi i rekomandon Ministrit të filloj hartimin e një propozimligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili siguron autonominë e Agjencisë.<br><br>Raporti i EQAR- Përjashtimi i AKA nga EQAR<br><br>Më 27 shkurt 2018, EQAR njoftoj vendimin për përjashtimin e AKA-së nga regjistri i tyre. Vendimi u ngrit në bazë të provave ekzistuese që vendimi i Ministrit për shkarkimin e të gjithë bordit të AKA-së (shtator 2017) nuk ishte i bazuar dhe si rezultat ai ka ndikuar në standardet e ESG. Shkarkimi u pasqyrua nga një diskutim publik, mbulim mediatik dhe kishte një ndikim të ndërmjetëm në agjendën e Ministrit për të marrë rolin udhëheqës dhe për ta kthyer situatën nën kontroll. Vlen të përmendet se çështja u diskutua në një mënyrë shumë konstruktive në të gjitha nivelet dhe çka është më e rëndësishme, Kuvendi i Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme (9 mars 2018), që u diskutua gjerësisht mbi zhvillimet e AKA / EQAR dhe si rezultat, e ngarkuan Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të zbatuar konkluzionet e tyre, të cilat synojnë kthimin e AKA-së në regjistrin e EQAR. Në pajtim me konkluzionet e Kuvendit të Kosovës, Ministri krijoi një grup punues për hartimin e UA të ri për procedurat e përzgjedhjes për anëtarët e bordit dhe kjo u krye me sukses. Bordi i ri u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 12 prill 2018. Më 24-26 |

| | |
|---|---|
| | shtator 2018, delegacioni i EQAR vizitoi Prishtinën ku zhvilloi një numër bisedimesh mbi hapat e nevojshëm për të rivendosur pavarësinë e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA) dhe për të hapur rrugën e saj për njohjen nga EQAR si një agjenci që vepron në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën e Arsimit të Lartë Evropian (ESG). AKA do t'i nënshtrohet një rishikimi të jashtëm kundër ESG në mars 2019 dhe deri atëherë është rënë dakord të ketë një ligj të posaçëm për AKA-në.<br><br>Raporti i EQAR<br><br>https://backend.deqar.eu/reports/EQAR/2018-02_Exclusion_Decision_C22_KAA.pdf |

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Rregullimi normativ i fushës së institucionit për akreditimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës

**Rritja e rëndësisë së sistemit të sigurimit të cilësisë dhe AKA-së**
Agjencia e Kosovës për Akreditim (AAK), është agjenci e pavarur, e themeluar me Ligjin e arsimit të lartë nr. 2002/3 nga MASHT. Sipas neneve 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 11.8, 11.9 dhe nenit 23.3 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, është paraparë themelimi i AAK me akt nënligjor si dhe në pika të shkurta me disa paragrafë, janë përcaktuar të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e AAK.
Me Udhëzimin administrativ nr. 11/2004, datë 16.02.2004, themelohet Agjencia e Kosovës për Akreditim (AAK) dhe më hollësisht rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e AAK si dhe përcaktohen procedurat e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.
Ligji për Arsimin e Lartë në fuqi, nr. 04/L-037 neni 7, paragrafi 1, përcakton se AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikat më të mira ndërkombëtare, AKA-ja siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (ENQA). Mirëpo, rregullimi i kompetencave të AKA-së bëhet me anë të Ligjit të arsimit të lartë, vetëm në vija të trasha.

Me Ligjin për Arsimin e Lartë në fuqi nr. 04/L-037 neni 7, paragrafi 1, nuk janë rregulluar në mënyrë të hollësishme çështjet si në vijim:

1. Procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë;
2. Procedurat e vendimmarrjes dhe parashtrimit të ankesave;
3. Formën e bashkëpunimit me institucionet e fushave përkatëse (institucionet si motra) si dhe institucionet e arsimit të lartë.
4. Nuk e ka përcaktuar strukturën organizative të AKA dhe
5. Mënyrën e financimit të AKA dhe pagesës së anëtarëve të KSHC për punën e tyre si dhe kostoja e procesit të akreditimit.

Me nenin 4 paragrafin 2.6 të UA nr.15/2018 për Akreditimin e IAL, rregullohet mandati i KSHC por nuk precizohet saktësisht zgjedhje e një numri të anëtarëve me rrotacion. Prandaj, kjo çështje duhet të rregullohet me dispozita ligjore.

Po ashtu, neni 4 paragrafi 3 përcakton se struktura administrative e AKA menaxhohet nga drejtori i AKA, por nuk përcaktohet cila është struktura administrative e AKA me çka në asnjë moment nuk ka pasur një akt nënligjor që ka rregulluar strukturën organizative ose Organogramin e Organizimit të Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të AKA. Rregullimi në vija të trasha i strukturës organizative ose Organogramin e Organizimit të Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të AKA me dispozita ligjore është i domosdoshëm.

Po ashtu, pozita juridike e AKA duhet të definohet qartë me dispozita ligjore se a është organ ekzekutiv i Kuvendit, Qeverisë apo Ministrisë. Pastaj, me dispozita ligjore duhet të përcaktohet se drejtorin e Agjencionit, cili organ e zgjedh sepse me legjislacionin në fuqi, drejtorin e Agjencionit e zgjedh Kryeministri.

Kjo çështje duhet të rregullohet me ligj pasi që obligimet financiare për IAL është më mirë që të përcaktohen me ligj, e jo me akte nënligjore të cilat mund të ndryshojnë lehtë dhe kështu mund të rritet kostoja financiare për procesin e akreditimit të IAL.

Funksionimi i Komisionit të Ankesave ka qenë jo funksional me nenin 22 paragrafin 6 të UA nr. 9/2017, sepse në Komision njëri nga anëtarët është përcaktuar që të jetë një ish anëtar ndërkombëtar i KSHC me ç'rast procedurat e ankesës janë komplikuar. Me nenin 22 paragrafët 6, 7 dhe 8 të UA nr. 15/2018, ka ndryshuar përfaqësimi i anëtarëve në KSHC, ku më nuk kërkohet ish përfaqësues ndërkombëtar nga KSHC. Prandaj, edhe kjo çështje duhet të rregullohet me Ligj që të mos ketë ndryshime të shpeshta të cilat do ta ulnin autoritetin e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave.

Me Udhëzimin administrativ për Akreditimin e IAL-ve nr. 15/2018 në Kosovë më hollësisht rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e AKA si dhe përcaktohen procedurat e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë. Duke pasur parasysh se sistemi i sigurimit të cilësisë në Kosovë çdo ditë e më tepër po evulon, institucionet e arsimit të lartë janë duke u zhvilluar dhe AKA duhet në përputhje me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë t'u përgjigjet këtyre zhvillimeve. Është e domosdoshme që AKA të fuqizohet më tepër në aspektin e funksionimit të saj. Roli i AKA-së që nga viti 2009 është duke u bërë tepër i rëndësishëm duke pasur parasysh se AKA është rregullatori kyç i sigurimit të cilësisë në Kosovë. Që nga themelimi i saj, AKA ka ndërmarrë veprime konsistente për sa i përket proceseve të saj, metodologjisë së punës, adaptimeve dhe përmirësimeve legjislative, etj. në mënyrë që të sigurojë se sistemi i

Kosovës përputhet me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë. Prandaj, është e domosdoshme që pas gjithë kësaj periudhe AKA të ketë ligjin e saj me të cilin do të rregulloheshin të gjitha çështjet që janë në sferën (domenin) e kësaj agjencie. Po ashtu, kjo fushë ndërlidhet edhe me legjislacionin e fushave tjera si në vijim:
Me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative me të cilin rregullohen procedurat e ankesave dhe organet që merren me shqyrtimin e ankesave si dhe afatet ligjore të parashtrimit të ankesave si dhe aktet administrative që nxjerrë. Ndërlidhja mes këtyre dy fushave ekziston sepse edhe AKA është e obliguar që ti respektojë të gjitha procedurat e ankesave dhe organet që merren me shqyrtimin e ankesave si dhe afatet ligjore të parashtrimit të ankesave dhe aktet administrative që nxjerrë.
Me nenet 22-26 dhe 51-55 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Agjencive në Kosovë.

Me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, përcaktohen pagat e gjithë sektorëve publik, prandaj duke pasur parasysh se Agjencia e Kosovës për Akreditim është në kuadër të sektorit publik ndërlidhja mes këtyre dy fushave ekziston në realizimin e të drejtave në pagë dhe shtesave në pagën bazë.

Me ligjin për Barazinë Gjinore nr.05/L-020 dhe Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi nr. 05/L-021 Rregullohet barazia gjinore dhe mosdiskriminimi.

Me Projektligjin e Arsimit të Lartë, rregullohen pjesërisht të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e AKA, por në nenin 13 paragrafin 15 parashihet që struktura organizative e AKA do të rregullohet me ligj të veçantë.

Duke pasur parasysh se me Projektligjin e Arsimit të Lartë është paraparë që struktura organizative e AKA, do të rregullohet me ligj të veçantë si dhe duke pasur parasysh se me legjislacionin në fuqi ka edhe paqartësi rreth formës së funksionimit, përzgjedhjes e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, kompetencave në mes MASHT dhe AKA në fushën e licencimit dhe akreditimit ku shpesh njëri ose tjetri institucion ka ndërmarrë veprime të cilat kanë çuar në kualifikimin e punëve siç është rasti kur edhe njëri edhe tjetri institucion, janë marrë me vlerësimin e hapësirave për zhvillimin e veprimtarisë, pastaj numrin e studentëve, bibliotekave, laboratorëve si dhe hapësirave e pajisjeve tjera dhe formës së financimit të AKA vlerësojmë se dispozitat ekzistuese kanë mjaft mangësi dhe kanë krijuar edhe konflikt të kompetencave, këto mangësi dhe ky konflikt kompetence qojnë në përfundimin se duhet miratuar ligj i ri i cili do rregullonte në mënyrë të qartë funksionimin e AKA si dhe pavarësinë e saj të plotë nga ndryshimet e shpeshta të legjislacionit në fuqi.

Ligji për arsimin e lartë në fuqi ka dispozita për Agjencinë e Akreditimit (Neni 3 paragrafi 1.1, paragrafi 1.16,) neni 5 paragrafi 1.1,1.4,1.5,1.6, neni 7 është nen i veçantë për AKA, mirëpo nuk ofron dispozita të qarta në disa nga paragrafet, për shembull si në vijim:
Neni 7, paragrafi 4. AKA duhet të qeveriset nga një bord i përbërë nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona, të emëruar nga Ministria për një mandat të caktuar, i cili duhet të përbëhet nga radhët e personave të të dy gjinive, që janë aktivë në punën akademike të arsimit të lartë dhe /ose në profesione brenda dhe jashtë Kosovës, i cili duhet të ketë të paktën tre persona

(ekspertë ndërkombëtarë), që nuk janë të punësuar nga asnjë bartës i arsimit të lartë në Kosovë. Ky bord do të quhet Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së. Anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Vendimet apo rekomandimet lidhur me akreditimet, Këshilli i merr me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Këshilli i raporton çdo vit Ministrisë dhe Kuvendit lidhur me aktivitetet e veta të akreditimit dhe me përshtatshmërinë e infrastrukturës mbështetëse që ka në dispozicion. Nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet ti raportojë për këtë Kuvendit.

Pra, nuk është e definuar nëse do të ketë një proces konkurrimi për Bord, në cilat raste mund të shkarkohen, pra shkarkimi duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm dhe jo siç ceket nëse për çfardo arsye. UA në fuqi nr. 06/2018 për KSHC ka të përshkruara kritere bazë për vendorët, por nuk është e definuar procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC ndërkombëtar.

**Përmbushja e standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG)**

Sipas Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG), të cilat AKA duhet ti përmbush në mënyrë që të jetë pjesë e mekanizmave evropiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, përkatësisht standardi 3.2 dhe 3.3., kërkojnë që "*agjencitë duhet të kenë një bazë ligjore të dëshmuar dhe duhet formalisht të njihen si agjenci të sigurimit të cilësisë nga autoritetet kompetente publike*" (3.2.) si dhe "*Agjencitë duhet të jenë të pavarura dhe të veprojnë në mënyrë autonome. Ato duhet të kenë përgjegjësi të plotë mbi veprimet e tyre dhe vendimet/ rezultatet e atyre veprimeve pa ndërhyrjen e palëve të treta*" (3.3). Sipas këtij të fundit, të qenit e pavarur konsiderohet një agjenci e cila ka:

- pavarësi organizative e cila demonstrohet me dokumentacion zyrtar (p.sh. instrumente të qeverisjes, akte legjislative apo statutet e organizatës) të cilat përcaktojnë pavarësinë e punës së agjencisë nga palët e treta, sikurse nga institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe organizata të tjera të interesit;
- pavarësi operacionale: përcaktimi dhe implementimi i procedurave dhe metodave të punës së agjencisë si dhe përzgjedhja e ekspertëve të jashtëm duhet të bëhet në formë të pavarur nga palët e treta sikurse institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe palë të tjera të interesit;
- Pavarësia e vendimeve/ rezultateve formale: përderisa ekspertët nga palët e interesit, posaçërisht studentët, marrin pjesë në procese të sigurimit të cilësisë, Agjencitë duhen të jenë të pavarura dhe të veprojnë në mënyrë autonome. Ato duhet të kenë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre dhe vendimet/ rezultatet e tyre pa ndikimin e ndonjë pale të tretë.

Nëse specifikisht analizohen këto dy standarde, ne mund të themi se Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për momentin nuk është plotësisht e pavarur as nga aspekti organizativ, operacional mirëpo edhe as nga aspekti i pavarësisë dhe operimit të saj si agjenci autonome. Duke qenë pjesë e shërbimit civil si nënprogram i pavarur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, AKA nuk është plotësisht e pavarur të bëjë organizimin e saj të brendshëm në përputhje me nevojat e saj. Disa procedura të AKA që ndërlidhen me aktivitetet e Drejtorit varen nga aprovimi i MASHT, apo nga ministritë e tjera relevante për sa i përket shtimit apo

ndryshimit të pozitave brenda agjencisë, si dhe përshkrimit të vendeve të punës së zyrtarëve të AKA-së.

Për sa i përket pavarësisë operacionale, AKA sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë është e pavarur në hartimin e politikave të saj në përputhje me Standardet Evropiane, mirëpo në shumicën e rasteve trajtimi i disa çështjeve të rëndësishme për procesin e akreditimit rregullohen me ligje të përgjithshme dhe rrjedhimisht dispozitat e udhëzimit administrativ për akreditim karshi Ligjeve të përgjithshme nuk vlejnë. AKA detyrohet që një pjesë të metodologjisë së saj ta përshtas në përputhje me dispozitat e përgjithshme ligjore të cilat në raste të caktuara cenojnë seriozisht cilësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit.

Kohët e fundit, AKA i ka kushtuar rëndësi të madhe çështjes së stafit akademik, duke siguruar që numri i stafit akademik është në përputhje të plotë me numrin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të përkatëse. Për arsye të mungesës së stafit vendor akademik, IAL-të private kanë angazhuar një numër masiv me nënshtetësi të Shqipërisë dhe Maqedonisë, të cilët anipse kanë angazhime të rregullta në universitetet e tyre amë, janë deklaruar si të rregullt edhe në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë. Angazhimi i profesorëve nga rajoni është një vlerë e shtuar për sistemin e arsimit të lartë në Kosovë, meqenëse kjo kontribuon që shtetet shqipfolëse të afrohen mes vete për sa i përket shkëmbimit të përvojave të mira në fushën akademike. Mirëpo, asesi personat e tillë nuk mund të konsiderohen për procesin e vlerësimit dhe akreditimit, meqenëse AKA kërkon nga IAL-të vetëm përmbushjen e kritereve minimale sa i përket stafit akademik. Përmbushja e kritereve minimale nuk duhet të varet plotësisht nga stafi rajonal, sepse është evidente që të njëjtit janë të angazhuar të rregullt në universitetet e tyre amë. AKA përmes një procesi të verifikimit të dyfishtë, ka vendosur disa standarde dhe kërkesa në raport me angazhimin e tyre në Kosovë. Duke qenë se çështja e punësimit që në disa raste konsiderohet se është e rregulluar me ligjin e përgjithshëm të punës dhe me ligjin për të huaj, shkakton problem rreth punësimit të rregullt të stafit, shtetas të huaj. Pra, legjislacioni në fuqi nuk ka kritere të qarta, andaj kjo do të adresohet në këtë konceptdokument si bazë për nxjerrjen e Ligjit për AKA. Nëse AKA, vendos kritere të qarta përmes këtij ligji sa i përket çështjes së angazhimit të stafit akademik, pa paragjykim ndaj shtetasve të huaj, mirëpo që siguron që ai staf me të vërtetë punon në Kosovë, një numër i madh i pengesave do të evitoheshin dhe rrjedhimisht AKA-së do ti kthehej besimi ndaj IAL-ve private.

**Përjashtimi i Kosovës nga EQAR**

Rëndësia e të qenit të pavarur plotësisht në vendimmarrje si dhe në veprimet e agjencive, është jetike për Kosovën nëse vendi ynë synon të jetë pjesë e mekanizmave evropian të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ishte pikërisht shkarkimi i menaxhmentit të AKA-së dhe KSHC-së arsyeja që në vitin 2018 Kosova u përjashtua nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), mekanizmi më i rëndësishëm i Komisionit Evropian për arsim të lartë. EQAR nuk ka mundur të identifikojë ndonjë arsyetim të vlefshëm prapa vendimit për shkarkimin e Bordit të AKA-së dhe rrjedhimisht ka arritur në përfundim që AKA nuk vepron në mënyrë të pavarur. Largimi i Kosovës nga EQAR është kthim prapa i një pune disavjeçare të AKA-së, si dhe paraqet pengesa serioze në drejtim të mobilitetit akademik, njohjes së kualifikimeve si dhe aspekte të tjera të rëndësishme në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Në anën tjetër, mekanizmi tjetër evropian për sigurim të cilësisë, po aq i rëndësishëm për Kosovën, ENQA, ka

kërkuar që AKA të vendoset si anëtare nën vëzhgim dhe ka organizuar vlerësim të parakohshëm për AKA-në, pikërisht për shkak të pavarësisë së AKA-së. Pavarësisht përpjekjeve serioze që janë bërë kohëve të fundit për të dëshmuar para faktorëve ndërkombëtarë, që pas përjashtimit të Kosovës nga EQAR janë bërë hapa serioz në drejtim të rikthimit të imazhit të AKA-së, si dhe stabilizimin e proceseve kryesore të AKA-së, për këto mekanizma është jetike që faktorët vendor në Kosovë të krijojnë bazën ligjore të AKA-së, nëse AKA dëshiron të mbetet pjesë e këtyre mekanizmave. Në muajin shtator 2018, MASHT u vizitua nga një delegacion i lartë evropian, përkatësisht nga udhëheqësit e EQAR, me qëllim të informimit për hapat e ndërmarrë nga MASHT për "restaurimin" e pavarësisë së AKA-së si dhe përpjekjet e tyre për të rikthyer përsëri AKA-në në EQAR si një agjenci e cila vepron në përputhje me ESG-të. Përfaqësuesit e EQAR mësuan për hartimin e udhëzimit administrativ nga MASHT për përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC-së, megjithatë ata theksuan rëndësinë e transformimit të këtyre dispozitave në një ligj, në mënyrë që ato dispozita të sigurojnë qëndrueshmërinë e pavarësisë së AKA-së. Ata theksuan se dy çështje janë me rëndësi kritike për kornizën e re ligjore: procesi transparent i nominimit të anëtarëve të KSHC-së, si dhe kushte tepër strikte për shkarkimin e anëtarëve të KSHC-së. Këto qëndrime të përfaqësuesve të EQAR janë publikuar në formën e një komunikate zyrtare në uebfaqen e EQAR, çka tregon qartë se mënyra e vetme që Kosova përsëri të kthehet në EQAR dhe të mirëmbajë anëtarësimin e saj në ENQA është krijimi i bazës së re ligjore, me theks që siguron pavarësinë e AKA-së.

**Rritja e stafit të AKA-së i nevojshëm për përmbushjen e misionit të AKA**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) numëron një staf tejet të vogël në krahasim me rëndësinë e proceseve të mandatuara sipas ligjit për arsimin e lartë me rreth 13 pozita, prej të cilëve të plotësuar 5 (2 femra dhe 3 meshkuj) të cilët ballafaqohen me rreth 32 institucione të arsimit të lartë dhe me rreth 358 programe. Sistemi i arsimit të lartë ka shënuar rritjen më të madhe në dekadën e fundit, ani pse dy vitet e fundit ka pasur mbyllje të disa institucioneve private të arsimit të lartë për shkak të mospërmbushjes së kritereve të cilësisë. Pavarësisht kësaj, përgjegjësitë e AKA-së në raport me numrin e madh të institucioneve, janë tepër të mëdha në krahasim me numrin e stafit administrativ brenda Agjencisë.

Sistemi i sigurimit të cilësisë në Kosovë çdo ditë e më tepër është duke evoluar. Përpos vlerësimit dhe akreditimit, AKA ka hartuar standardet për monitorim ESG 2015. Realizimi i procesit të monitorimit domosdoshmërisht rrit cilësinë e punës së AKA-së, mirëpo në anën tjetër kërkon numër më të madh të stafit i cili në mënyrë efikase i përgjigjet numrit të madh të institucioneve të arsimit të lartë. Procesi i monitorimit është pjesë komplementare e procesit të akreditimit, duke pasur parasysh numrin e rekomandimeve apo kushteve të cilat jepen me rastin e vlerësimit dhe akreditimit. Është shumë e rëndësishme që këto dy procese të realizohen në mënyrë efektive në mënyrë që misioni i AKA-së të përmbushet plotësisht dhe rrjedhimisht të rritet cilësia e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Me gjendjen ekzistuese është e pamundur që një proces i tillë të realizohet duke pasur parasysh që numri aktual i zyrtarëve të AKA-së nuk plotëson as nevojat e procesit të vlerësimit dhe akreditimit. Në anën tjetër, sigurimi i cilësisë në Kosovë është një çështje relativisht e re dhe nuk ka kuadër të mjaftueshëm i cili potencialisht mund të kyçet në AKA. Kuadri aktual me përvojë në sigurim të cilësisë, është më tepër i kyçur në institucione të arsimit të lartë, pjesërisht edhe si staf akademik. Kërkesat aktuale për punësim në AKA, kërkojnë përvojë pune, njohje të gjuhës angleze si dhe njohuri për fushën e sigurimit të cilësisë të cilat kritere në raport me kompensimin mujor dekurajojnë personat

profesional dhe me eksperiencë të angazhohen në AKA. Burimet njerëzore të kufizuara të AKA-së, janë cilësuar si problematike edhe në raportin e vlerësimit të jashtëm të AKA-së nga ENQA në vitin 2014, dhe potencialisht kjo çështje do të adresohet përsëri me rastin e rivlerësimit të AKA-së në vitin 2019. Rritja e stafit të AKA-së, me persona adekuat dhe profesional, do ti shërbente pozitivisht ruajtjes së anëtarësisë së Kosovës në ENQA. AKA ka hartuar Raportin e Vetëvlerësimit në përputhje me udhëzuesit e ENQA për vlerësim të jashtëm dhe e ka dorëzuar atë në Sekretarinë e ENQA. Ky raport është hartuar nga një grup punues ekspertësh të arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë, përfshirë pjesëtarë të KSHC-së, AKA-së, ekspertë vendor dhe të huaj të financuar nga projekti HERAS. Ky raport para se të dorëzohej në ENQA është dërguar për diskutim publik tek të gjithë akterët relevant dhe më datë 19 nëntor është diskutuar në një punëtori me pjesëmarrje të të gjithë akterëve relevant, përfshirë IAL-të, përfaqësues të BE-së dhe donatorëve, studentëve, shoqërisë civile, etj.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën zyrtare | Institucion i(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim | Roli dhe detyrat e institucionit(-eve) |
|---|---|---|---|
| Udhëzim administrativ nr. 11/2004 dt. 16.02.2004 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7201 | MASHT/AKA | Udhëzim administrativ nr. 11/2004 dt. 16.02.2004 |
| Ligji i arsimit të lartë 04/L-037 | Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës: nr. 14/2011, dt. 09.09.2011 | MASHT<br>IAL<br>AKA | Neni 5- specifikon se çdo IAL mund të aplikoj për licencë vetëm pasi të jetë akredituar.<br><br>MASHT është autoriteti përgjëgjës për hartimin e akteve ligjore dhe zbatimin e tyre.<br><br>IAL janë përgjegjëse të veprojnë vetëm të akredituara dhe licencuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | AKA është përgjegjës për akreditimin institucional dhe të programeve te studimit. |
| Udhëzim administrativ për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë nr. 9 Dt. 02.08.2017 | www. masht.rks-gov.net | MAS HT AKA/ KSH C IAL | Akreditimi i IAL<br><br>MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për nxjerrjen akteve nënligjore për AKA.<br><br>AKA/KSHC zbatojnë parimet, kriteret dhe standardet e këtij UA gjatë procesit të akreditimit.<br><br>IAL janë të obliguara të respektojnë dhe zbatojnë këtë UA me rastin e akreditimit, riakreditimit të Institucionit dhe programeve. |
| Udhëzim administrativ për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë nr. 15/2018 dt. 28.09.2018 | Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 15/2018 dt. 05.10.2018 (Pjesa e parë dhe e dytë) | MAS HT AKA IAL | Rregullimi dhe zbatimi i akteve ligjore ( MASHT)<br>Përcaktimi i kritereve të qarta për akreditim( MASHT dhe AKA).<br>Pranimi/vlerësimi dhe procedurat e aplikimit për IAL (MASHT, AKA).<br>Afatet kohore (MASHT dhe AKA)<br>Emërimi i Këshillit shtetëror për cilësi- Roli dhe kompetencat ( MASHT dhe AKA)<br>Aplikimi për akreditim i IAL bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë UA.<br>Procedurat për ankesa<br>Marrja e Vendimeve (AKA)<br>(KSHC/AKA)<br><br>MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për nxjerrjen akteve nënligjore për AKA.<br><br>AKA zbaton parimet, kriteret dhe standardet e këtij UA gjatë procesit të akreditimit në pajtim me standardet evropiane (ESG) .<br><br>IAL janë të obliguara të respektojnë dhe zbatojnë këtë UA me rastin e akreditimit, riakreditimit të Institucionit dhe programeve. |
| Udhëzim | www. masht.rks-gov.net | MAS | MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 15/2018 të dt. 28.09.2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë Nr. 16/2018 Datë 02.11.2018 | | HT AKA/ KSH C IAL | nxjerrjen akteve nënligjore për AKA.<br><br>AKA/KSHC zbatojnë parimet, kriteret dhe standardet e këtij UA gjatë procesit të akreditimit.<br><br>IAL janë të obliguara të respektojnë dhe zbatojnë këtë UA me rastin e akreditimit, riakreditimit të Institucionit dhe programeve. |
| Udhëzim administrativ për kriteret dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të këshillit shtetëror të cilësisë të Agjencisë të Kosovës për akreditim Nr. 06/2018 Dt. 07.05.2018 | www. masht.rks-gov.net | MAS HT AKA/ KSH C IAL Kuve ndi | Roli i KSHC, emërimi, etj.<br><br>MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për nxjerrjen akteve nënligjore për KSHC dhe propozimin e anëtarëve për KSHC.<br><br>KSHC është organ vendimmarrës në AKA.<br><br>AKA bën akreditimin e IAL bazuar në vendimet e KSHC .<br><br>IAL marrin vendimet lidhur me procesin e akreditimit nga AKA/KSHC.<br><br>Kuvendi bën aprovimin e anëtarëve të KSHC. |
| Udhëzim administrativ për Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës | www. masht.rks-gov.net | ENIC /NAR IC MAS HT IAL Të punës uarit | Njohjet e diplomave të fituara jashtë vendit ndërlidhen me organe akredituese kredibile, apo të tjera me qëllim të njohjes së diplomave të huaja për përdorim/punësim në Republikën e Kosovës.<br><br>MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për nxjerrjen akteve nënligjore për të rregulluar njohjen/barazvlerën e studimeve të fituara jashtë vendit.<br><br>Zyra ENIC/NARIC në MASHT duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe përmes komunikimit me zyrat përgjegjëse të shteteve ku janë kryer studimet bën njohjen/barazvlerën e studimeve të IAL të akredituara dhe licencuara të njohura nga vendi i origjinës.<br><br>IAL mund të punësojnë stafin si shtetas të huaj vetëm nëse |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. 12/2018<br>Dt. 10.09.2018 | | | kanë të nostrifikuar studimet e tyre në MASHT.<br><br>Të gjithë të interesuarit të cilët kanë fituar thirrje akademike, për të qenë pjesë e stafit akademik duhet të aplikojnë për njohje/barazvlerë të studimeve të tyre në MASHT me qëllim të punësimit. |
| Standardet dhe udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në zonën evropiane për arsim të lartë ESG 2015 | https://enqa.eu/indirme/esg/ESG%20in%20Albanian_by%20KAA.pdf<br><br>https://enqa.eu/index.php/home/esg/ | | AKA zbaton këto standarde të miratuara nga Ministrat përgjegjës për arsim të lartë (EHEA) dhe Agjencitë e cekura me:<br>ENQA dhe në bashkëpunim me ESU,EURASHE,EUA,EQAR,CEENKA |
| Udhëzim administrativ për Sistemin e menaxhimit të informatave në arsimin e lartë (SMIAL) Nr. 13/2018 Datë 21.09.2018 | www. masht.rks-gov.net | MAS HT IAL | Të gjitha IAL duhet të regjistrojnë të dhënat në sistemin elektronik SMIAL që menaxhohet nga MASHT. Sistemi ndërlidhet me vendimet e AKA për IAL/ programet e tyre, numrit të studentëve, stafit akademik dhe të tjera.<br>Njëherit ndërlidhet edhe me verifikimin e dokumenteve të studentëve për përdorim jashtë vendit.<br><br>MASHT është autoriteti dhe rregullatori përgjëgjës për nxjerrjen akteve nënligjore për të rregulluar sistemin SMIAL , ku obligon të gjitha IAL të regjistrojnë të dhënat e kërkuara dhe ti raportojnë sipas këtij UA.<br><br>IAL obligohen të regjistrojnë të dhënat e kërkuara ( studentët, stafin, programet, etj) në këtë platformë elektronike dhe dorëzojnë regjistrat e studentëve në kopje fizike në MASHT sipas afateve kohore të përcaktuara me këtë UA dhe vetëm për programet valide të akredituara. |
| Plani Strategjik i arsimit në Republikën e Kosovës 2017-2022<br>Plani i veprimit të planit strategjik 2017- 2022 PSAK | www. masht.rks-gov.net | MAS HT, AKA, IAL | MASHT në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe AKA synojnë dhe janë përgjegjës në arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë strategji.<br><br>MASHT, IAL janë përgjegjëse në kryerjen e aktiviteteve sipas planit të veprimit |
| Prioritetet strategjike (PSAK 2017- | www. masht.rks-gov.net | MAS HT, IAL, | Objektivi 7 ("Arsimi i lartë"). Në këtë objektiv, përqendrimi është në sigurimin e jashtëm të cilësisë që realizohet përmes mbështetjes së AKA dhe aplikimit të sistemit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2022) | | AKA | Rezultati 7.3: Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional 7.3.1. Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të AKA-së për t'i zbatuar standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.<br><br>7.6.4. Rishikimi i programeve ekzistuese të studimit |
| Plani strategjik 2016 -2020 | https://enqa.eu/index.php/about-enqa/strategic-plan-2016-2020/<br>Dt. 17 prill 2015 | ENQA dhe të gjitha institucionet që janë anëtarë në ENQA | Miratuar nga asambleja e përgjithshme e ENQA. Vizioni i zonës evropiane për arsim të lartë është që studentët kanë qasje në arsim cilësor dhe kualifikime të respektuara dhe pranuara brenda dhe jashtë vendit. |
| Rekomandimet e ENQA për Ministrat përgjegjës për arsim të lartë | https://enqa.eu/wp-content/uploads/2018/05/ENQA_message_Paris_2018.pdf<br>https://enqa.eu/wp-content/uploads/2015/04/ENQA_report_Yerevan_2015.pdf | ENQA | Roli i MASHT dhe AKA është të përmbushin dhe përmirësojnë legjislacionin,standardet dhe të tjera bazuar në kërkesat dhe rekomandimet edhe të partnerëve ndërkombëtar |
| Qasja evropiane për sigurim të cilësisë për programe të përbashkëta | https://www.eqar.eu/assets/uploads/2018/04/European_Approach_QA_of_Joint_Programmesv1_0-2015.pdf miratuar nga Ministrat përgjegjës për zonën evropiane të arsimit të lartë (EHEA)<br><br>https://www.eqar.eu/assets/uploads/2018/04/EQAR_Statutes_ENv3_0-2017.pdf | EQAR, ENQA,ESU,EUA,EURASHE,CEENKA | Rregullat e përcaktuara për programe të përbashkëta dhe zbatimi i standardeve ESG për të gjitha institucionet e arsimit të lartë.<br><br>AKA vepron bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe standardet ESG të përcaktuara nga këta mekanizma evropian për sigurim të cilësisë.<br><br>IAL gjatë procesit të akreditimit obligohen ti përmbushin këto standarde. |
| Strategjia kombëtare për zhvillim 2016- | http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombëtare_për_Zh | Zyra e Krye | Ndërlidhja e sistemit arsimor me tregun e punës si prioritet i qeverisë ku fokusi ka të bëjë me programet e arsimit dhe përcaktimi i fushave prioritare |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2021 | villim_2016-2021_shqip.pdf , janar 2016- | ministrit, Institucionet e Kosovës | |
| Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative | www. map.rks-gov.net | MAP | Ndërlidhja mes këtyre dy fushave ekziston sepse edhe AKA është e obliguar që ti respektoj të gjitha procedurat e ankesave dhe organet që merren me shqyrtimin e ankesave si dhe afatet ligjore të parashtrimit të ankesave, aktet administrative që nxjerrë. |
| Ligji nr. 06/l - 113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura | www. map.rks-gov.net | MAP | Nenet 22 - 26 dhe 51 - 55 ku përcaktohet krijimi, organizimi dhe funksionimi i Agjencive. |
| Ligji 06/L-114 për Zyrtarët Publik | www. map.rks-gov.net | MAP | Duke pasur parasysh se të punësuarit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim janë në kategorinë e zyrtarëve civil nenet 2 dhe nga 31-67 të Ligjit për zyrtarët publik këto dy fusha janë të ndërlidhura mes vete sepse të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të AKA rregullohen me Ligjin për zyrtarët publik. |
| Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik | www. map.rks-gov.net | MAP | Duke pasur parasysh se Agjencia e Kosovës për Akreditim është në kuadër të sektorit publik, ndërlidhja mes këtyre dy fushave ekziston në realizimin e të drejtave në pagë dhe shtesave në pagën bazë. |
| Rekomandimet e Kuvendit për MASHT | www. Kuvendi i Republikës së Kosovës | Kuvendi i Republikës së Kosovës | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova -Republic of Kosovo**
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

Legjislatura VI

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65.9 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, pas debatit parlamentar, të zhvilluar në seancën plenare, të mbajtur më 7 mars 2018, sipas kërkesës së GP të LDK-së dhe GP të LVV-së, si dhe harmonizimit të tekstit edhe me GP të PDK-së, GP të AKR-së dhe GP "Nisma", nxjerr këto

R E K O M A N D I M E

1. Brenda afatit të ankimimit të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për të kthyer AKA-në si anëtar i rregullt në EQAR.
2. Ministri të raportojë në Kuvend për:
   a. Arsyet e shkarkimit të Bordit, duke ofruar informata për Komisionin Funksional (në raportim me dyer të mbyllura, nëse është e nevojshme),
   b. Për veprimet që janë ndërmarrë ndaj ish-anëtarëve të Bordit për shkeljet e pretenduara që mund t'i kenë bërë ata.
3. Ministri ta tërheqë nga Kuvendi për verifikim propozim-vendimin për anëtarë të Bordit.
4. Në afatin prej shtatë (7) ditësh, një ekip pune, i përbërë nga të gjitha palët (ekspertë të arsimit, përfaqësues të Ministrisë, përfaqësues të organizatave që monitorojnë punën e arsimit të lartë dhe të tjerë) të përpatisë Udhëzimin Administrativ që miratohet nga ministri, i cili do t'i përcaktojë kriteret dhe procedurat transparente për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit.
5. Bazuar në këtë Udhëzim Administrativ, lista e anëtarëve të Bordit të procedohet në Kuvend për miratim.
6. Kuvendi obligohet që brenda dhjetë (10) ditësh, nga dita e dorëzimit të propozim-vendimit nga Qeveria, ta radhisë në rend dite të seancës plenare për miratim.
7. Kuvendi i rekomandon ministrit të fillojë hartimin e një propozim-ligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili siguron autonominë e Agjencisë.

Nr. 06-DO-485
Prishtinë, 07. 03. 2018

Kryetari i Kuvendit:
Kadri Veseli

Rekomandimet u dërgohen:
- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
  MASHT-it,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Problemi kryesor** | Paqëndrueshmëri institucionale e AKA- në raport me detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e misionit të saj dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë |
| **Shkaqet** | Ndërrimi i shpeshtë i akteve nënligjore<br>Ndërhyrjet në pavarësinë e AKA<br>Ndryshimet e shpeshta të menaxhmentit të AKA<br>Mungesa e resurseve njerëzore<br>Mungesa e hapësirave të AKA-së<br>Mosrealizimi i procesit të monitorimit të mirëfilltë në mungesë të mjeteve financiare dhe burimeve njerëzore<br>Përjashtimi i Kosovës nga EQAR si rezultat i cenimit të pavarësisë së saj<br>Mungesa e ligjit të AKA<br>Buxheti jo i mjaftueshëm<br>Mungesa e harmonizimit të procesit të akreditimit me procesin e licencimit të IAL<br>Mungesa e profilizimit të IAL. |
| **Efektet** | Ndryshimi i shpeshtë i Udhëzimit administrativ për Akreditim krijon pasiguri dhe jo stabilitet në mesin e institucioneve të arsimit të lartë dhe nuk i kontribuon zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit të arsimit të lartë.<br>Mungesa e ligjit të veçantë në raste të caktuara cenon pavarësinë operacionale dhe vendimmarrëse të Këshillit Shtetëror të Cilësisë që kohëve të fundit është bërë jetike për Kosovën në raport me mekanizmat evropian të sigurimit të cilësisë (ENQA; EQAR; CENKA).<br>Resurset e kufizuara njerëzore, financiare dhe infrastrukturore të AKA-së vështirësojnë realizimin e plotë të misionit të AKA-së dhe cenojne cilësinë e proceseve të sigurimit të cilësisë.<br>Mungesa e një ligji të veçantë pengon AKA-në në vendosjen e metodologjisë së saj që i përputhet karakteristikave specifike të procesit të |

vlerësimit, akreditimit dhe monitorimit.

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| Emri i palës së interesuar | Shkak-u/qet me të cilat është e lidhur pala | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet) |
|---|---|---|---|
| Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT) | Mosdefinimi i qartë i legjislacionit rezulton në institucione/programe të arsimit të lartë jo kredibile për vazhdimin e studimeve, tregun e punës brenda dhe jashtë vendit si dhe pamundësi për mobilitetin akademik. Ndërhyrjet politike të grupeve të interesit. | Definimi jo i qartë i akteve ligjore mund të rezultoj në vendime joadekuate me pasoja për sistemin e arsimit. Mundësi e madhe e përballjes me inicim të procedurave të ankesave nga palët e dëmtuara e cila mund të ketë kosto të lartë financiare. | MASHT është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dhe politikëbërjes për gjithë sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës dhe ndërlidhet me të gjitha palët e interesit si studentët, institucionet e arsimit të lartë, institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, dhe të tjera. |
| Agjencia e Kosovës për akreditim (AKA) | Sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe UA për Akreditim, AKA është bartëse e procesit të akreditimit në nivel institucional dhe të programeve të studimit të IAL-ve | Mosdefinimi si duhet i procedurave dhe ndryshimet e shpeshta te akteve nënligjore kanë shkaktuar pasoja juridike për AKA-në, deri ne atë masë që IAL-të te iniciojnë edhe procedura gjyqësore për këto çështje | AKA procesin e akreditimit e realizon bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë, dhe UA për Akreditim |
| Institucionet e arsimit të lartë(IAL) | Mungese e pavarësisë së plotë të AKA-së nga politika, e që ndikon në kërkesat e parashtruara nga IAL për akreditim si dhe rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të punës së AKA-së në | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala janë si në vijim: 1. Infrastruktura ligjore e përsëritshme e cila siguron se AKA do të merr vendime të pavarura me rastin e | IAL janë prekur nga shkaqet, efektet e KD për AKA, sepse obligohen që në afate ligjore të aplikojnë për akreditim dhe duke shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar nga |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | shqyrtimin e kërkesave për akreditim si dhe ankesave kundër vendimeve të AKA | shqyrtimit të aplikacioneve të IAL.<br><br>2. Kryerja e procedurave të përcaktuara ligjore me rastin e shqyrtimit të ankesave të IAL nga Komisioni për Ankesa në AKA | AKA si institucion i cili është anëtare e ENQA dhe EQAR që të merr vendimet në afatet e përcaktuara ligjore si organ i pavarur, sepse ky institucion monitorohet drejtpërdrejt nga këto organizata nëse me punën e saj i përmbush ESG-s ose jo. |
| Qytetarët e Republikës së Kosovës | Mospërshtatja e programeve të akredituara me nevojat e tregut të punës | Përgatitja e kuadrove në shpërputhje me nevojat e tregut të punës | Qytetarëve si taksapagues nuk i ofrohet arsim i mjaftueshëm cilësor. |
| Studentët | Mospërputhja e përmbajtjeve të programeve të akredituara me zbatimin praktik të tyre<br><br>Raporti student-profesor në shpërputhje me nevojat | Mungesë e cilësisë adekuate të studimeve<br><br>Mungesë e cilësisë në mësimdhënie | Pamundësi për qasje në tregun e punës<br><br>Arritje e kufizuar e kompetencave |
| Institucionet ndërkombëtare | Mungesë e pavarësisë së plotë të AKA-së nga politika, e që ndikon në kërkesat dhe kushtet e parashtruara nga institucionet ndërkombëtare | Infrastruktura ligjore e pjesërishme që cenon anëtarësimin e plotë të AKA-së në organizatat ndërkombëtare. | AKA është anëtare e ENQA dhe EQAR dhe monitorohet drejtpërdrejtë nga këto organizata nëse me punën e saj i përmbushë ESG ose jo |
| Kuvendi | Mungesa e informatave të nevojshme për fushë veprimtarinë e AKA | Vendimmarrje joadekuate në raport me nevojat dhe punën e AKA | Kuvendi mandaton KSHC dhe monitoron në periudhë periodike punën e KSHC. |
| Bizneset | Mungesa e kritereve të funksionalizimit të bordeve industriale | Planifikimi i profileve joadekuate | Mungesa e infrastrukturës ligjore që përcakton kriteret e qarta për emërimin e bordeve |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | industriale nuk pasqyron nevojën e bizneseve për hartimin e programeve studimore. |

Kapitulli 2: Objektivat

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Objektivi relevant** | **Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)** |
|---|---|
| **Objektivat strategjike** | |
| 1. Sigurimi i cilësisë në IAL, në mënyrë që institucionet e përcaktuara të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e procesit të akreditimit në të gjitha IAL-të; | Ligji i arsimit të lartë nr. 04/L-037 i publikuar me dt. 09.09.2011<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761<br><br>Plani Strategjik për Arsim 2017- 2021<br><br>Objektivi Strategjik/OS 3: Sigurimi i Cilësisë Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.<br><br>Objektivi Strategjik/ OS 7: Arsimi i Lartë Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.<br><br>Rezultati 7.3: Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksional 7.3.1. Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të AKA-së për t'i zbatuar standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë |

| | |
|---|---|
| | në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.<br><br>https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf<br><br>UA për SMIAL<br><br>Plani Strategjik për Arsim 2017- 2021<br><br>(Zyrat për sigurim të cilësisë) |
| 2. Sigurimi i infrastrukturës ligjore që do të mundësoj që procesi i akreditimit të administrohet në mënyrë të pavarur dhe autonome në mënyrë që institucionet e përcaktuara të kenë përgjegjësi të plotë për proceset, menaxhimin dhe vendimet e tyre. | Dokumentet përkatëse të planifikimit janë:<br><br>Ligji i arsimit të lartë nr. 04/L-037 i publikuar me dt. 09.09.2011<br><br>Ligji që do të hartohet për AKA<br><br>Udhëzimet administrative që do të dalin nga ligji për AKA<br><br>Plani Strategjik për Arsim 2017- 2021 |
| 3. Pavarësia e plotë institucionale e AKA në vendimmarrje si dhe kryerja e obligimeve dhe përgjegjësive me efikasitet dhe efektivitet në afatet e përcaktuara me legjislacion. | Plani Strategjik për Arsim 2017- 2021<br><br>Rekomandimi i Kuvendit<br><br>ENQA, EQAR<br><br>Rregullore e KSHC |
| 4. Monitorimi i punës së IAL për realizimin e obligimeve që dalin nga Vendimet e Akreditimit në afatet e përcaktuara për monitorim. | Ligji i arsimit të lartë nr. 04/L-037 i publikuar me dt. 09.09.2011<br><br>Ligji që planifikohet të hartohet për AKA<br><br>Udhëzimet administrative që do të dalin nga ligji për AKA<br><br>Plani Strategjik për Arsim 2017- 2021 |

Kapitulli 3: Opsionet

Opsionet të cilat mund të prezentohen do të ishin: 1. Opsionin asnjë ndryshim; 2. Opsioni i dytë rregullimi me ligj të veçantë për funksionimin e AKA-së dhe Opsioni 3. për ndryshimin e gjendjes ekzistuese.

Opsioni i parë (Opsionin asnjë ndryshim): Ky opsion nuk ndryshon gjendjen ekzistuese, pasi që gjendja jo e mirë, ka detyruar mekanizmat kompetent (Kuvendi përmes rekomandimit) të mendojnë për avancimin e statusit të AKA-së.

Opsioni i dytë, rregullimi me ligj të veçantë për funksionimin e AKA-së, është mënyra më e mirë e sigurimit të pavarësisë së plotë të AKA-së, krijimit të stabilitetit juridik (duke shmangur mundësinë që në vazhdimësi të ndryshohen UA për Akreditim), dhe aprovimin e strukturës së re funksionale të AKA-së. Bazuar në parimin e drejtësisë, që ligji i veçantë e përjashton ligjin e përgjithshëm, me rregullimin e kësaj çështje me ligj të veçantë, do të vendoseshin kriteret dhe procedurat të cilat do ti lejonin AKA-së që shumë probleme me të cilat është përballë deri më tani në punën e vet, t'u jepet zgjidhje meritore me ligj të veçantë, siç është çështja e stafit akademik të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, etj. Praktikisht për të siguruar pavarësi, stabilitet dhe profesionalizëm, çështja e AKA-së do të duhej të rregullohej me ligj të veçantë, me ç'rast do të sigurohet ngritja e cilësisë.

Opsioni i tretë për ndryshimin e gjendjes ekzistuese (ndryshimi i Ligjit mbi Arsimin e Lartë). Edhe sikur të kishte mundësi të ndryshohet Ligji mbi Arsimin e Lartë dhe të plotësohej me pjesën për AKA, nuk është praktikë që me ketë ligj të definohet funksionimi i agjencive të pavarura siç pretendohet të jetë AKA. Për me tepër gjendja juridike e AKA nuk është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e mekanizmave ndërkombëtar pjesë e së cilave është AKA, andaj kërkohen ndryshimet në drejtim të avancimit të pozitës së këtij institucioni e jo të degradimit të saj.

Ndryshimi i qasjes së zbatimit të legjislacionit aktual mes akterëve si AKA, MASHT, dhe gjithë të tjerëve, apo edhe rritja e numrit të stafit duke kërkuar nga Qeveria/Ministria e Financave dhe Administratës publike në kuptimin që do të forcoheshin burimet njerëzore në AKA dhe ngritja e buxhetit. Por edhe kjo prap nuk eshte opcion i mjaftueshem për adresimin e problemeve sepse nuk siguron qëllimin kryesor të pavarësisë së AKA. Andaj rekomandohet opcioni 2 per nxjerrjen e ligjit për AKA ku siq kemi cekur edhe problemet e mësiperme ku ndryshimi i shpeshtë i akteve nënligjore na sjell vështirësi implementuese të politikave. Gjithashtu shkakton konfuzitet tek IAL nxjerrja e akteve dhe plotësim ndryshimeve në raport me kërksat e akreditimit dhe zbatimit të këtyre akteve në praktikë, pasi që secili ndryshim shkakton pasoja juridike në procedurat që janë duke u zhvilluar nga AKA.

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Ky opsion nuk ndryshon gjendjen ekzistuese. Procesi i akreditimit si proces i ndarë nga licencimi te IAL në Kosove ka filluar nga viti 2009 me themelimin e AKA për akreditim. Çdo IAL sipas ligjit aktual të AL në fuqi dhe akteve nënligjore të gjitha IAL i nënshtrohen akreditimit/riakreditimit institucional dhe të programeve. Ndërrimet e shpeshta të akteve nënligjore, ndërhyrjet e shpeshta në funksionin e AKA kanë krijuar jostabilitet në AKA dhe të gjitha IAL. Si rezultat e kemi edhe përjashtimin e AKA nga EQAR. Gjithashtu, mungesa e resurseve njerëzore ka rezultuar në ngecjen e kryerjes së një segmenti tejet të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë siç është monitorimi i IAL. Pjesa dërmuese e funksionimit të AKA, është e rregulluar me legjislacion primar dhe sekondar si në vijim:

Ligji i arsimit të lartë nr. 2002/3, Ligji i arsimit të lartë 04/L-037, Udhëzimi administrativ nr. 11/2004 i dt. 16.02.2004 -Themelimi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Udhëzimi administrativ për kriteret dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të këshillit shtetëror të cilësisë të Agjencisë të Kosovës për Akreditim nr. 06/2018 dt. 07.05.2018, Udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 15/2018 të dt. 28.09.2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë nr. 16/2018 datë 02.11.2018.

Opsioni i parë nuk shihet si zgjidhje nga nga partnerët ndërkombëtar dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, sepse nuk e ndryshon gjendjen aktuale.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Opsioni për 'përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit' është një opsion që duhet të merret parasysh në çdo Konceptdokument në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Konceptdokumenteve.

Dispozitat ligjore dhe nënligjore nuk kanë qenë të harmonizuara mes vete dhe me standardet ndërkombëtare që rregullojnë veprimtarinë e AKA, prandaj propozohet që të ketë ligj të veçantë, i cili siguron funksionim të drejtë, efikas dhe të pavarur të kësaj agjencie. Ky ligj do të siguronte stabilitet juridik, aprovim të strukturës së re organizative të AKA-së, rritje të kapaciteteve profesionale, efikasitet të punës së AKA-së në trajtimin e çështjeve funksionale.

Në aspektin juridik, ky ligj do të rregullonte funksionimin e AKA-së, dhe do të vendoste korniza edhe në nxjerrjen e akteve administrative, vetëm për çështjet të cilat nuk do të definoheshin me këtë ligj. Përmes këtij ligji do të definohej saktë misioni dhe fushëveprimtaria e AKA-së në raport me institucionet e tjera me qëllim të shmangies së kolezioneve si në aspektin ligjor përmes akteve administrative, ashtu edhe në atë të kompetencave.

Përmes këtij ligji, AKA synon edhe aprovimin e strukturës së re organizative me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale të cilat do të siguronin realizimin e misionit të AKA-së, në të gjitha

segmentet në të cilat AKA ka pasur të pamundshme ti përmbush plotësisht deri më tani, siç është komponenta e monitorimit të IAL-ve.

Mosdefinimi i qartë i strukturës organizative ka ndikuar në efikasitetin dhe funksionimin joefikas të AKA, si dhe ngecje në procesin e monitorimit të plotë pas akreditimit. Gjithashtu, zbrazëtirat ligjore në akte që kanë rregulluar funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, kanë rezultuar me kritere jo të qarta rreth procedurave të emërimit dhe shkarkimit të cilat pastaj kanë rezultuar me pasojat në procesin e akreditimit. Standardet dhe udhëzuesit (ESG 2015) sa u përket burimeve njerëzore, si standard ceket : Agjencitë duhet të kenë burime të përshtatshme dhe të duhura, si njerëzore, ashtu dhe financiare për të kryer punën e tyre (shih uebfaqen https://enqa.eu/indirme/esg/ESG%20in%20Albanian_by%20KAA.pdf).

Agjencitë në rajon kanë një numër të lartë të stafit krahasuar me numrin e stafit të AKA-së në Kosovë si për shembull Kroacia ka një anëtar të stafit për një institucion, përderisa AKA ka pasur një anëtar të stafit për gjashtë institucione dhe kjo ka sjellë edhe vështirësinë e monitorimit apo mbikëqyrjes së IAL. Si statistikë për raportin e numrit të stafit dhe institucioneve në vendet tjera janë:

Slloveni: stafi: 32 - IAL: 50

Kroaci: stafi: 45 - IAL: 50

Bullgari: stafi: 34 - IAL: 50

Kosovë: stafi: 13 - IAL: 32 ( sqarim, AKA ka pasur 5 pozita të plotësuara, dhe 8 të paplotësuara për shkak të problemeve në rekrutim të stafit). Deri më tani AKA ka hapur disa herë konkurse për plotësimin e vendeve të lira, por në disa raste është detyruar që ta anuloj konkursin në mungesë të plotësimit të kritereve nga ana e kandidatëve. Një tjetër arsyeje që mund të përmendet në mosplotësimin e vendeve të lira, është fakti që, AKA nga nëntori i vitit 2014 është me ushtrues të detyrës së drejtorit, fakt ky i cili nuk varet nga AKA, dhe ndërrimi i shpeshtë i këtyre personave si ushtrues të detyrës së drejtorit ka bërë që ky proces asnjëherë të mos përmbyllet. Arsyeja që kërkohet staf më i madh më poshtë në opcionin e propozuar është për shkak se nëse me ligjin e ri definohen qartë dhe lejohen divizionet e propozuara, atëherë stafi administrativ duhet të jetë i ndarë nga ai profesional, në mënyrë që të rritet efikasiteti në kryerjen e aktiviteteve në AKA pa qenë nevoja që përmes MASHT të miratohen kërkesa të ndryshme rreth buxhetit dhe të tjera. Stafi i propozuar do të ndikonte direkt në rritjen e cilësisë duke qenë aktiv në monitorimin dhe vlerësimin e IAL dhe duke bashkëpunuar me IAL përkatese.

Kosova ka funksionuar me një numër jashtëzakonisht të vogël deri tani në vitin 2018. (burimi: (http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/Ndikimi-i-procesit-t%C3%AB-akreditimit-n%C3%AB-SC-n%C3%AB-AL-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-1.pdf)

Synimet për anëtarësim në zonën evropiane të arsimit të lartë dhe respektimi i standardeve evropiane, si dhe rekomandimi i Kuvendit për nxjerrjen e ligjit dhe rekomandimet e

mekanzimave ndërkombëtar janë që AKA të ketë ligjin e vet ku do të përcaktohen të gjitha kriteret dhe standardet për ngritje dhe menaxhimin e cilësisë në AL.

Me ligj të veçantë synohet që qëllimi, objektivat dhe parimet e ligjit që përmes procesit të akreditimit AKA mbështet dhe garanton barazinë para ligjit për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe studentët, diveristetin dhe cilësinë e programeve të studimeve.

Po ashtu, përcaktohen kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim si Agjenci e pavarur ku misioni i saj kryesor është vlerësimi, monitorimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre.

Ky opsion propozohet për të siguruar stabilitet dhe siguri në mesin e anëtarëve të KSHC, si dhe për të siguruar se sistemi i sigurimit të cilësisë në Kosovë është i qëndrueshëm dhe nuk mund të lëkundet me rastin e ndryshimit të Qeverive. Është tejet e rëndësishme që përzgjedhja e anëtarëve të KSHC-së të rregullohet me Ligjin e Agjencisë.

Siç është parë edhe nga mungesa e stafit në AKA, do të përcaktohet struktura organizative e AKA-së siç është:

Struktura e përhershme administrative e AKA-së, e cila menaxhohet nga drejtori i AKA. Drejtori i AKA zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për shërbyesit civil.

Por, nëse mendohet që AKA duhet të jetë plotësisht e pavarur në të gjitha sferat e funksionimit të saj, kërkesë kjo e derivuar nga të gjithë mekanizmat ndërkombëtar ku AKA është anëtare ENQA dhe synon të rikthehet në EQAR atëherë numri i stafit të nevojshëm duhet të rritet të paktën 19 pozita shtesë nga numri aktual i miratuar, pasi që atëherë do të duhej të krijohen tri departamente në shtatë divizione dhe pozita të cilat momentalisht nuk ekzistojnë:

1. Departamenti për akreditim, vlerësim dhe monitorim (dy divizione: divizioni për vlerësim dhe akreditim dhe divizioni për monitorim),
2. Departamenti për administratë dhe financa (tri divizione: divizioni për buxhet dhe financa, divisioni i prokurimit, divisioni i burimeve njerëzore dhe divizioni për shërbimet teknike).
3. Departamenti për legjislacion (dy divizione: Divizioni për legjislacion dhe divizioni për monitorim të zbatimit të legjislacionit).

Struktura organizative e AKA përbëhet nga:

- Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) dhe
- Struktura e përhershme e administrative e AKA-së.

Struktura e përhershme e administrative e AKA-së udhëhiqet nga drejtori i AKA-së. Kjo strukturë do të ketë këtë përbërje: Drejtori i AKA-së, tri departamente, me shtatë divizione.

Drejtori i AKA-së është personi kryesor administrativ në këtë institucion, dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së stafit permanent të AKA. Drejtori i AKA-së është edhe anëtar i KSHC-së sipas detyrës zyrtare, pa të drejtë vote. I gjithë stafi i AKA-së për punën e vet i përgjigjen drejtorit. Sipas propozimit, AKA do të ketë tri departamente, dhe atë: Departamenti për vlerësim, akreditim dhe monitorim, i cili do ti ketë dy divizione. 1. Divizioni për vlerësim dhe akreditim (5 zyrtarë) , dhe 2. Divizioni për monitorim (5 zyrtarë), Departamenti për administratë dhe financa i cili do të ketë tri divizione: 1. Divizioni për buxhet dhe financa (5 zyrtarë), 2. Divizioni i prokurimit (3 zyrtarë), 3. Divizioni i burimeve njerëzore dhe divizioni për shërbimet teknike (3 zyrtarë) dhe Departamenti për legjislacion i cili do të ketë dy divizione: 1. Divizioni për legjislacion (3 zyrtarë) dhe 2. Divizioni për monitorim të zbatimit të legjislacionit (3 zyrtarë).

Gjithashtu, si pjesë e strukturës së AKA-së, do të jenë edhe këto pozita:Drejtori i AKA, asistent ekzekutiv në zyrën e drejtorit të AKA-së dhe auditori i brendshëm i AKA-së.

Si pjesë e strukturës AKA-së është edhe Komisioni i Ankesave, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, përkatësisht nga 3 anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë/alternativ.

Me këtë KD duhet të arsyetohet fakti i përfshirjes së pozitave zyrtare në këtë ligj dhe trajtim meritor bazuar në specifikat që i ka AKA. Me këtë ligj duhet të definohet saktë koeficienti për pozitat e rëndësisë së veçantë për AKA, dhe asesi të mbesin siç janë. Zyrtarët të cilët marrin pjesë në procesin e akreditimit, vlerësimit dhe monitorimit, për shkak të ndjeshmërisë së procesit, do të duhej që me ligjin për AKA-në të parashihet që koeficienti të rregullohet sipas ligjeve në fuqi.

Ky ligji do të ketë edhe ndikim/impakt buxhetor, sepse me këtë do të rregullohej njëherë e përgjithmonë edhe struktura funksionale e AKA-së, duke e paraparë edhe organogramin e ri dhe koeficientët për secilën pozitë në AKA.

Këshilli shtetëror i cilësisë (KSHC) si organ politikëbërës dhe vendimmarrës i AKA-së, do të ketë jo më pak se shtatë (7) anëtarë dhe jo më shumë se nëntë (9) anëtarë, ku së paku tre prej tyre do të jenë ndërkombëtarë. Po ashtu, në përbërjen e strukturave vendimarrëse si në KSHC dhe komisionin e ankesave, respektohet ligji për barazinë gjinore. Drejtori i AKA, sipas detyrës zyrtare është anëtar shtesë i KSHC pa të drejtë vote.

Vendimet e KSHC do të merren me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet. Asnjë vendim nuk mund të merret për akreditim/riakreditim pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar. KSHC do të udhëhiqet nga kryetari i KSHC dhe në mungesë të tij udhëhiqet nga nënkryetari. KSHC kryen detyrat në bazë të ligjit për AKA, udhëzimeve administrative që dalin nga ky ligj që pritet të miratohet, dhe rregullores së KSHC. Kompensimi i anëtarëve të KSHC bëhet duke u bazuar në UA për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28.09.2018).

Kriteret dhe procedurat për emërimin e anëtarëve të KSHC do të bëhet si në vijim:

Në përbërjen e KSHC duhet të jenë së paku tre anëtarë të gjinisë së kundërt dhe një nga komunitetet pakicë. Përbërja e KSHC do të ketë së paku nga një anëtar vendor për secilin grup. Grupet e mëposhtme të fushave të studimit:

a. Edukimi, shkencat humane dhe artet;
b. Shkencat shoqërore, biznesi dhe drejtësia;
c. Shkencat e natyrës, matematika, shkencat kompjuterike dhe inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi;
d. Shëndeti dhe mirëqenia, bujqësia dhe veterina.

Mandati i KSHC do të jetë:

Tre (3) anëtarë ndërkombëtar emërohen me mandat pesëvjeçar;

Tre (3) anëtarë vendor emërohen me mandat pesëvjeçar;

Tre (3) anëtarët e tjerë vendor emërohen me mandat për tri (3) vite vetëm për mandatin e parë.

Përcaktimi i mandateve të KSHC-së për herë të parë bëhet me short.

Përcaktimi i mandateve të kryetarit apo nënkryetarit të KSHC, përcaktohet për herë të parë për tri (3) ose pesë (5) vite varësisht nga shorti, kurse herëve të tjera varësisht nga mandati i mbetur i anëtarit të KSHC.

Anëtarët e KSHC mund të rizgjidhen edhe për një mandat të dytë.

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC janë: Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, përjashtim bëjnë anëtarët ndërkombëtar, të kenë gradën Doktor i shkencave me përvojën relevante akademike ose dhjetë (10) vite përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë së arsimit të lartë, njohje të gjuhës angleze. Gjithashtu, në rast se anëtarët vendor janë të diplomuar jashtë Republikës së Kosovës të kenë njohje të diplomës në MASHT.

Ky ligj do të përcaktoj se kush nuk mund të jetë anëtar i KSHC si në vijim:

- Personi që ka ushtruar një post politik në dy (2) vitet e fundit;
- Është themelues, bashkëthemelues, aksionar, anëtar i bordit ose bartës i funksionit menaxherial në ndonjë institucion i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
- Më së shumti tre (3) anëtarë vendor të KSHC mund të kenë angazhim aktual në institucionin e njëjtë;
- Ka kryer vepër penale;
- Konstatohet se ka konflikt interesi.

Ky proces për propozim të anëtarëve të KSHC do të përcillet përmes konkurrimit të hapur publik ku MASHT bën ftesë publike për nominimin e anëtarëve të KSHC.

E drejta për të nominuar do të jetë e hapur për të gjithë personat juridik të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe personat fizik shtetas të Republikës së Kosovës, me ç'rast afati për

nominim është 15 ditë pune. Ky proces shihet si proces transparent dhe i hapur duke ju dhënë qasje për konkurrim të barabartë.

Për procedurat e vlerësimit, Ministri (MASHT) do të formojë Komisionin i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve të nominuar dhe do të bëj listën e ngushtë të kandidatëve, e cila duhet të jetë së paku sa dyfishi i anëtarëve që zgjidhen duke respektuar fushat dhe përbërjen gjinore. Kjo listë e ngushtë i dërgohet Ministrit që të emëroj anëtarët e KSHC i cili vendim bëhet publik dhe përcillet për aprovim në Kuvend.

Emërimi për anëtarët ndërkombëtar bëhet përmes konsultimeve dhe propozimeve me partnerët ndërkombëtarë.

Pjesë e kërkuar nga gjithë komuniteti vendor dhe ndërkombëtar si proces shumë i nevojshëm dhe i qartë do të jetë edhe dispozita se kur mund të shkarkohet një anëtar i KSHC. Kjo gjithsesi përcillet, edhe afatet kohore për ankesa si e drejtë legjitime e personit të shkarkuar.

Në bazë të ligjit për arsimin e lartë në Kosovë asnjë institucion nuk mund të veproj pa pasur akreditim nga AKA dhe licencë nga MASHT. Pra, janë dy procese të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën që domethënë në rast se i mungon njëra, IAL nuk mund të filloj punën.

Për të bashkërenditur aktivitetet e sipërme dhe për të dhënë një afat kohor të përgatitjes për fillimin e vitit akademik për IAL me dt. 1 tetor, KSHC do të mbaj mbledhjen e fundit në janar të vitit aktual kur institucioni mendon të filloj punën në tetor të këtij viti, ku nga shkurt deri prill, IAL mund të përfundoj edhe procedurën e licencimit në MASHT. Kjo do të bëhet me qëllim të harmonizimit dhe përcaktimit të afateve të qarta për akreditim por edhe licencim.

Përmes kritereve dhe procedurave të përcaktuara për të gjitha IAL që veprojnë në Kosovë, AKA do të ofroj informatat e duhura në nivel vendi dhe më gjerë për mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin i cili kërkohet, vlerësimin, afatet kohore për aplikim dhe vlerësim, vendimet e KSHC, afatin për ankesë, tarifat e pagesës, monitorimin si dhe cilat janë standardet që kërkohen të përmbushen nga një IAL siç janë standardet ESG.

Përmes këtij ligji do të hartohen dispozitat si në vijim:

**Qëllimi**

Qëllimi i Ligjit është fuqizimi dhe pavarësia në vendimarrje e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), si dhe rritja e efikasitetit për shqyrtim të kërkesave, aplikim të procedurave dhe standardeve për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve e tyre të studimit në Republikën e Kosovës përmes një procesi transparent dhe llogaridhënës.

**Përkufizimet**

**Përkufizimet do të përfshijnë përshkrimin e të gjitha institucioneve relevante në këtë KD.**

**Objektivat**
- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies nga MASHT, AKA dhe IAL;
- Konkurushmëria e bazuar në standarde në mes të IAL-ve dhe programeve të studimit me interes për studentë, tregun e punës dhe shoqërinë;
- Inkurajimi i inovacionit në arsimin e lartë;
- Implementimi i objektivave strategjike për arsimin e lartë;
- Antarësimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë;
- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë.

**Parimet**
Përmes procesit të akreditimit, AKA garanton, mbështet dhe njeh:
- Lirinë akademike, siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe interpretimi pasues nga gjyqësori;
- Barazinë para ligjit e të gjithë bartësve të arsimit të lartë;
- Mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe stafin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim;
- Diversitetin dhe cilësinë e programeve të studimit;
- Kreativitetin, inovacionin dhe ndërmarrësin si qëllime kryesore të bartësve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;
- Qasjen evropiane dhe ndërkombëtare në të gjitha fushat e arsimit të lartë, për të mundësuar mobilitetin e studentëve dhe stafit dhe krahasueshmërinë e standardeve të diplomave dhe kualifikimeve;
- Përkushtimin për kërkime dhe dije shkencore për të mbështetur mësimdhënien dhe mësim-nxënien, dhe për të zgjeruar kufijtë e dijes dhe të të kuptuarit brenda dhe jashtë Kosovës;
- Ngritja e cilësisë dhe konkurueshmërisë përmes përmirësimitë mësimdhënie, kërkime shkencore, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit;
- Angazhimin aktiv të studentëve si në aspektin individual ashtu edhe në atë kolektiv, në jetën e institucionit të tyre dhe në mësim-nxënien e tyre.

**Statusi i AKA**

Agjenci e pavarur ekzekutive

**Fushëveprimi i AKA**

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes procesit të vlerësimit, akreditimit dhe monitorimit të IAL-ve.

**Struktura organizative e AKA ( Menaxhmenti dhe stafi i AKA, KSHC)**

Struktura orgaizative e AKA përbëhet nga:

-Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) dhe
-Struktura e përhershme administrative e AKA-së
-Komisioni i Ankesave

**Fushëveprimi i KSHC**

KSHC zbaton politikat strategjike të arsimit të lartë të Qeverise së Republikes së Kosovës/ MASHT.
KSHC është organ politik bërës dhe vendimmarrës i AKA-së;
KSHC harton dhe miraton statutin e AKA-së, rregullore dhe dokumente të tjera të ndevojshme për funskionimin e AKA-së;
KSHC miraton dhe zbaton standardet ESG;
KSHC i raporton MASHT dhe Kuvendit të Republikës të Kosovës

**Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxhmentit dhe stafit të AKA**

Struktura e përhershme administrative e AKA-së është përgjegjëse për të përmbushur të gjitha detyrat administrative të AKA-së.

Detyrat kryesore janë:
- organizimi dhe mbikëqyrja e procesit të vlersimit dhe akreditimit
- organizimi dhe mbikëqyrja e procesit te vleresimit dhe monitorimit
- Bashkërendon veprimet e AKA-së me MASHT dhe KSHC që lidhen me procesin e vlerësimit dhe akreditimit.
- Koordinon përgatitjen e raporteve përmbledhëse nga rekomandimet e raporteve të vlerësimit gjate procesit te akreditimit dhe monitorimit dhe i dorëzon ato në KSHC për miratim.
- Zbaton të gjitha vendimet e KSHC-së.

Struktura e përhershme administrative e AKA-së menaxhohet nga Drejtori i AKA-së.

**Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të KSHC**

Ministri emëron anëtarët e KSHC nga lista e kandidatëve të nominuar e hartuar nga Komisioni, pasi të ketë siguruar paraprakisht pëlqimin personal me shkrim të secilit prej tyre. Vendimi për emërim bëhet publik dhe dërgohet për miratim Kuvendit të Kosovës. Detajet për procesin e emërimit dhe shkarkimit janë specifikuar në UA nr.06/2018 dt.07.05.2018 të cilat do të përfshihen gjatë hartimit të Ligjit.

**Komisioni i ankesave.**

Sipas UA për Akreditim nr.15/2018 të dt.28.09.2018.

**Financimi i AKA**

AKA do të financohet nga buxheti i Qeverisë së Kosovës

**Kërkesa për akreditim**

Akreditimi mund të kërkohet nga:

1.Vet Institucioni i arsimit të lartë për nivelin e institucionit dhe/ apo programeve të tij të studimit;

2.Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);

3.Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) së AKA-së në raste specifike.

**Akreditimi fillestar dhe riakreditimi**

1.Secili institucion i cili pretendon të ofroj arsim të lartë në Kosovë i nënshtrohet akreditimit fillestar.

2.Institucionet e akredituara të arsimit të lartë i nënshtrohen ri/akreditimit në baza periodike në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në vendimet e KSHC-së.

**Aplikimi për akreditim nga IAL**

Sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe Manualit të AKA-së

**Procedura e akreditimit/riakreditimit**

Sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe Manualit të AKA-së

**Përzgjedhja e vlerësuesve të jashtëm**

Drejtori i AKA-së do të hartojë listën e vlerësuesve të jashtëm dhe do t'i propozojë ata tek Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) për miratim vjetor.

**Përbërja e ekipit të vlerësuesve të jashtëm**

1.Secili ekip i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga minimum 2 deri maksimum 7 vlerësues të jashtëm/, varësisht nga numri i programeve të studimit që vlerësohen.

2.Në ekipin e vlerësuesve të jashtëm do të emërohet të paktën një student për të vlerësuar çështjet studentore gjatë vlerësimit të institucionit të arsimit të lartë.

3.Vlerësuesit e jashtëm të njëjtë mund të përdoren për të vlerësuar programe të ngjashme në institucione të ndryshme.

4.Njëri nga anëtarët e ekipit të vlerësuesve të jashtëm do të caktohet si kryesues i ekipit dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e hartimit të Raportit të vlerësimit.

5. Institucionet e arsimit të lartë njoftohen për përbërjen e ekipit të vlerësuesve të jashtëm dhe kërkohet pajtimi i tyre.

**Detyrat e vlerësuesve të jashtëm**

1.Detyrat kryesore të vlerësuesve të jashtëm janë:
1.1.Shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara nga institucioni para vizitës në institucion;
1.2.Realizimi i vizitës në institucionin e arsimit të lartë të aranzhuar nga AKA;
1.3.Hartimi i draft raportit të vlerësimit pas vizitës së realizuar në terren;
1.4.Shqyrtimi i komenteve të dorëzuara nga institucioni për gjendjen faktike të draft raportit;
1.5.Finalizimi i raportit të vlerësimit për institucionin e arsimit të lartë.
1.6.Dorëzimi i raportit të vlerësimit në AKA.

**Vizita në institucionin e ekipit të vlerësuesve të jashtëm**

Vizitat tek institucionet duhet të strukturohen për të përmbushur kërkesat e procesit të akreditimit të caktuar (akreditimi fillestar institucional, programet e reja akademike ose riakreditimet) dhe duhet të koordinohen me institucionin.

**Raporti i vlerësimit**

1.Ekipi i vlerësuesve të jashtëm e harton Raportin e vlerësimit duke u bazuar në dëshmitë e mbledhura gjatë vizitës në terren, përmbajtjes së Raportit të Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin tjetër të bashkangjitur.
2.Ekipi i vlerësuesve të jashtëm i përmbahet Udhëzuesve të AKA-së për hartimin e raporteve të vlerësimit të ofruara nga AKA.

**Vendimi për akreditim**

1. Drejtori i AKA-së harton një përmbledhje të raportit duke u bazuar në raportin e vlerësimit të ekipit të vlerësuesve të jashtëm dhe ia paraqet atë KSHC-së.
2. Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendim për akreditim ose mos akreditim.
3. AKA do të publikojë në ueb faqen e saj vendimet për ri/akreditim si dhe raportin e vlerësimit të vlerësuesve të jashtëm për çdo institucion të arsimit të lartë dhe program studimi duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.
4. AKA do të njoftojë MASHT-in për të gjitha vendimet për ri/akreditim të KSHC-së, në mënyrë që MASHT të vazhdojë procedurën e licencimit sipas UA për Licencim.

**Kohëzgjatja e akreditimit**

1. Kohëzgjatja e akreditimit institucional fillestar (paraprak) është tri (3) vjet dhe e ri/akreditimit jo më shumë se pesë (5) vjet, përveç rasteve ku ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër dhe kur ai rekomandim merr pajtimin e KSHC-së.

2. Kohëzgjatja e ri/akreditimit të programit është tri (3) deri në pesë (5) vjet, përveç rasteve ku ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër dhe kur ai rekomandim merr pajtimin e KSHC-së.

**Procedurat pas marrjes së riakreditimit**

Institucionet e akredituara duhet të dorëzojnë tek AKA në fillim të çdo viti akademik një raport vjetor gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e tyre, duke përfshirë planin e përmirësimit (aktivitetet përcjellëse) të bazuar në rekomandimet e përfshira në raportin e ekipit të vlerësuesve të jashtëm.

**Revokimi/tërheqja e akreditimit**

1.AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim.

2.AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur.

**E drejta ankimore**

Sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, UA për Akreditim 15/2018 të dt.28.09.2018, dhe Rregulloren e punës së Komisionit të Ankesave.

**Programet e studimit me akreditim ndërkombëtar**

1. Çdo institucion mund të propozojë të ofrojë në Kosovë programe të studimit (frashiza) të cilat shpijnë në marrjen e një grade akademike apo diplomë të huaj, me kusht që këto programe të studimit të institucionit të huaj të arsimit të lartë janë të akredituara nga një agjenci e njohur e sigurimit të cilësisë nga ENQA, EQAR dhe CHEA.
2. Të gjitha këto propozime dhe kërkesa duhet të aprovohen nga AKA.

**Standardet e akreditimit**

1. Standardet e akreditimit janë rregulla të cilat përkufizojnë nivelin obligativ që duhet të arrihen nga institucionet e arsimit të lartë.
2. Standardet e akreditimit bazohen në praktikat evropiane dhe globale të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, duke u bazuar por mos u kufizuar vetëm në Udhëzuesit dhe Standardet Evropiane të Sigurimit të Cilësisë.

Institucionet e arsimit të lartë duhet ti përmbushin standardet të përcaktuara me ligj;

-Standardet e cilësisë për akreditim institucional

- Standardet e cilësisë për programet e studimit

- Standardet e cilësisë për programet e studimeve profesionale

- Standardet e cilësisë për akreditimin e degëve dhe programeve të studimit në degë

**Sigurimi i cilësisë dhe monitorimi**

1. AKA bënë monitorim dhe kontrollin e cilësisë në IAL-të e akredituara.
2. Monitorimi dhe kontrollimi i cilësisë në aspektin profesional të fushës/programeve realizohet nga vlerësues të jashtëm ndërkombëtarë.
3. Monitorimi dhe kontrollimi i cilësisë në aspektin administrativ realizohet nga stafi i AKA.
4. Koston e procesit të monitorimit e mbulon AKA.
5. Monitorimi i IAL-ve të akredituara organizohet nga AKA.
6. AKA do të bëjë publike rregulloret, standardet dhe politikat e monitorimit.

**Deklarimi i stafit akademik për angazhim**

IAL-të duhet të dorëzojnë deklaratat e angazhimit rreth marrëdhënies se punës të stafit akademik jo më larg se data 31 tetor e vitit kalendarik, përmes Platformës elektronike: E-Akreditimi.

AKA në çdo kohë mund të bëjë verifikimin e të dhënave të paraqitura në deklaratat e angazhimit të stafit akademik.
Deklarata jo e saktë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas nenit 392, do të procedohen zyrtarisht pranë organeve kompetente.

**Shpenzimet e procesit të akreditimit/riakreditimit**

1. Institucioni do të bartë të gjithë koston për procesin e akreditimit dhe riakreditimit institucional dhe te programeve.
2. Nëse institucioni i arsimit të lartë në marrëveshje me AKA-në e tërheq aplikacionin e tij para vizitës së vlerësuesve të jashtëm, pasi të ketë mbuluar shpenzimet e procesit të akreditimit, institucionit do ti kompensohen 50% të shumës së paguar për shpenzimet e akreditimit.

**Kompensimi i anëtarëve të KSHC**

Anëtarët e KSHC për punën e tyre do të kompensohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi për pagat në sektorin publik.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Ndryshimi i bazës ligjore të AKA-së, përmes ndryshimeve të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe akteve të tjera nënligjore, nuk siguron pavarësi në funksionimin e AKA-së.

Edhe sikur të kishte mundësi të ndryshohet Ligji mbi Arsimin e Lartë, dhe të plotësohej me pjesën për AKA, nuk është praktik që me këtë ligj të definohet funksionimi i agjencive të pavarura siç pretendohet të jetë AKA. Po ashtu, funksionimi i AKA-së përmes Udhëzimeve administrative të cilat janë ndryshuar në vazhdimësi, kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punës së AKA. Për më tepër gjendja juridike e AKA nuk është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e mekanizmave ndërkombëtar pjesë e së cilave është AKA, andaj kërkohen ndryshimet në drejtim

të avancimit të pozitës së këtij institucioni. Dispozitat ligjore dhe nënligjore nuk kanë qenë të harmonizuara mes vete si dhe me standardet ndërkombëtare që rregullojnë fushën e akreditimit.

Mosdefinimi i qartë i pozitës së AKA dhe synimet për integrim në zonën evropiane të arsimit të lartë rezultojnë me domosdoshmërinë për fuqizimin e AKA nëpërmes hartimit të ligjit dhe miratimit të tij brenda afateve të nevojshme për rianëtarësim në ENQA dhe EQAR.

Përjashtimi nga këto mekanizma ndërkombëtar mund të ketë për pasojë edhe largimin nga Korniza evropiane e kualifikimeve (KEK) në të cilën Kosova është anëtare, si dhe rrezikon mospranimin e diplomave të arsimit të lartë mbështetur në Konventën e Lisbonës për njohje.

Ndryshimi i qasjes së zbatimit të legjislacionit aktual mes akterëve si AKA, MASHT, dhe gjithë të tjerëve, apo edhe rritja e numrit të stafit duke kërkuar nga Qeveria/Ministria e Financave dhe Administratës publike në kuptimin që do të forcoheshin burimet njerëzore në AKA dhe ngritja e buxhetit, por edhe kjo prap nuk është opcion i mjaftueshem për adresimin e problemeve sepse nuk siguron qëllimin kryesor të pavarësisë së AKA. Andaj rekomandohet opsioni i dytë (2) për nxjerrjen e ligjit për AKA ku siq kemi cekur edhe nga problemet e mësiperme ku ndryshimi i shpeshtë i akteve nënligjore na sjell vështirësi implementuese të politikave. Gjithashtu shkakton konfuzitet tek IAL nxjerrja e akteve dhe plotësim ndryshimeve në raport me kërksat e akreditimit dhe zbatimit të këtyre akteve.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

*Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** |
|---|---|
| Ndikimet ekonomike | Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, prandaj është një sfidë por edhe mundësi e vërtetë për AL-të për të siguruar arsim cilësor dhe për përgatitjen e brezave të rinj për tregun e punës që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve pika 1.2. dhe 1.2.1 Fushat prioritare në KASH-in 2019-2021. Prioritetet janë paraqitur në mënyrë specifike dhe rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim, duke i kushtuar vëmendje gjithashtu masave të paraqitura në Programin për Reforma në Ekonomi 2018-2020, si dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Prioritetet më poshtë gjithashtu bazohen në dokumente të tjera strategjike sektoriale, duke iu mundësuar organizatave buxhetore |

| | |
|---|---|
| | një masë të fleksibilitetit për të përcaktuar strukturën më të përshtatshme dhe nivelet më adekuate të financimit për të arritur këto qëllime. Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2019 me parashikimet për periudhën afatmesme (2019-2021), nga organizatat buxhetore pritet të tregojnë se si plani i tyre buxhetor u përgjigjet prioriteteve të Qeverisë të paraqitura më poshtë. Kundrejt prioriteteve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.<br><br>**Ndërsa pika 1.2. 1. Arsimi:** ***Cilësia dhe konkurrueshmëria e arsimit të lartë*** synohet të rritet përmes plotësimit të kornizës ligjore për arsimin e lartë, si dhe plotësimin e akreditimit me një proces të rangimit të programeve dhe institucioneve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, raportim më kuptimplotë për universitetet si dhe do të ofrojë informata objektive për punëdhënësit dhe kështu përmirëson edhe punësueshmërinë e të rinjve. Përveç kësaj, Qeveria është e përkushtuar drejt funksionalizimit të plotë të sistemit të menaxhimit të informatave në arsimin e lartë (SMIAL), i cili së bashku me zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve të tjera të informatave do të mundësojë përdorimin e të dhënave të këtij sistemi për të siguruar që programet e studimit në arsimin e lartë janë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Financimi për programet e arsimit të lartë dhe ato të arsimit profesional do të rritet nëpërmjet rishikimit të formulës aktuale të financimit dhe duke i riorientuar shpenzimet nga fushat më pak prioritare në ato më prioritare. Në fund, sa i përket lidhjes së punës hulumtuese në IAL-te me industrinë përmes qasjes në specializimin e mençur dhe investimeve në hulumtim dhe zhvillim, fokusi kryesor do të jetë përmirësimi i kornizës ligjore për transferimin e inovacionit dhe teknologjisë, si dhe financimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore.<br><br>Me kryerjen e procedurave te akreditimit AARK ndikon edhe në ekonominë e vendit sepse institucionet e akredituara përpos që punësojnë një numër të madh të qytetarëve, po ashtu sjellin dhe pajisje dhe mjete të teknologjisë së fundit që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. |
| Ndikimet shoqërore | Avancimi i kornizës ligjore në lidhje me akreditimin e programeve studimore universitare ka ndikime të shumta. Kosova ka numër të |

| | |
|---|---|
| | madh të institucioneve të arsimit të lartë -32 institucione, shumica e të cilave janë kolegje. Së bashku, të gjitha institucionet e arsimit të lartë ofrojnë 358 programe studimi, duke përfshirë tri ciklet e studimit sipas Bolonjës. Në këto institucione janë të regjistruar rreth 140.000 studentë. Ndikimet janë shoqërore dhe individuale dhe përkojnë me zhvillimin e 'kapitalit njerëzor'. Njohja, shkathtësitë dhe gjykimi që farkëtohet përmes arsimit gjejnë shprehje në profesione dhe vende të punës, por edhe në jetën e përditshme. Marrë në përgjithësi, ndikimet shoqërore mund t'i referohen këtyre dimensioneve. Së pari, avancimi i kornizës ligjore në akreditim ka ndikim të drejtpërdrejtë në proceset e Evropianizimit të Kosovës sepse ofron perspektiva për një arsim cilësor, të krahasueshëm dhe kompatibil me arsimin dhe diplomat e fituara në Kosovë, me ato në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Ruajtja e statusit anëtar të AKA në Asociacionin Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsim të Lartë –ENQA dhe rikthimi i agjencisë në mekanizmat tjerë ndërkombëtar, siç është EQAR, rrit besueshmërinë në institucion dhe transparencën në vendimmarrje. Ky rikthim do i kontribuonte ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Kosovë, shtimit të mobiliteti akademik dhe njohjes së diplomave të arsimit të lartë të Kosovës në Evropë dhe më gjerë - Konventa e Lisbonës për Njohje https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168007f2c7 ).<br><br>Së dyti, ndikimet shoqërore ndërlidhen me përfitimet ekonomike. Arsimi cilësor mundëson punësim dhe si rezultat një shoqëri me arsim cilësor ka shkallë të ulët të papunësisë dhe varfërisë. Arsimi cilësor mund të rezultojë në shkallë më të lartë të inovacionit, prodhimit dhe aplikimit të teknologjive të reja, si parakusht për rritje ekonomike. Po ashtu, ndikimi shoqëror ka të bëjë me mobilitetin akademik dhe 'qarkullimin e trurit' si vendndodhje të një procesi dinamik në ndërtimin e dijes dhe inovacionit përgjatë sektorit publik dhe privat.<br><br>Së fundi, përfitimet shoqërore i referohen potencialit për zhvillim të një qytetarie aktive për të mirën publike, respektim të të drejtave të njeriut dhe mundësi të barabarta në zhvillim akademik dhe profesional në arsimin e lartë.<br><br>Me miratimin e KD dhe pastaj aktit juridik me të cilin do funksionalizohet AKA do të ketë ndikime shoqërore sepse me këtë rast do krijohej një pavarësi juridike e këtij institucioni, e cila do ta mbante larg ndikimeve politike dhe se shoqëria do realizonte të drejta në kushte të barabarta në këtë institucion pa ndikime nga jashtë. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka |

| | |
|---|---|
| Ndikimet në të drejtat themelore | Gjithëpërfshirja për qasje në arsim cilësor për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim të përkatësisë së tyre gjinore, etnike, fetare, moshës, gjuhës, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etj.<br><br>Promovimi i të drejtave të njeriut dhe barazisë të të gjithe qytetarëve përgjatë kurrikulës dhe programeve të studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë<br><br>Fuqizimi i IAL dhe studentëve në aplikimin e të drejtave të njeriut në studime, hulumtime, profesion dhe jetën e përditshme.<br><br>Principet e të drejtave të njeriut të bëhen pjesë e programeve të studimit dhe praktikave institucionale në IAL, arritjes së kompetencave përmes programeve cilësore dhe të krahasueshme me standardet evropiane për të arritur një qytetari aktive për vendimarrje demokratike. |
| Ndikimi gjinor | Gjinia formëson dhe po ashtu i jep formë praktikave institucionale dhe arritjeve në arsim. Pabarazia gjinore në arsimin e lartë dhe prodhimin e dijes është problem universal dhe po ashtu nacional. Rregullat dhe praktikat ligjore dhe institucionale, edhe kur në dukje janë neutrale, mund të diskriminojnë gratë. Ndryshimi institucional në sferën e arsimit të lartë kërkon intervenime përgjatë niveleve të ndryshme me qëllim të transformimit të rregullave formale dhe normave kulturore që diskriminojnë njërën gjini në favor të tjetrës.<br><br>Në Kosovë, gratë kanë shkallë të ulët të pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në punësim. Më pak se 10% e ndërmarrjeve në Kosovë janë biznese që udhëhiqen nga gratë. Segregimi i profesioneve mbi bazë gjinore është prezente. Gratë janë të punësuara në arsim (21%), shëndetësi (17%) dhe tregti (14%). [1] Këto të dhëna shpërfaqin prezencën e hendekut gjinor në arsim. Ndikimet gjinore ndërlidhen me standardet dhe cilësinë e programeve të studimit, kulturën institucionale për gjininë dhe diversitetin, si dhe intervenimet për promovim të barazisë gjinore.<br><br>Ndikimet përmes legjislacionit që marrin për bazë gjininë si kategori përbërëse të raporteve shoqërore, politike dhe institucionale janë një shtysë drejt transformimit të pabarazive gjinore, të arritshme përmes qasjes në arsim dhe programeve të studimit që përfshijnë përmbajtje gjinore. Po ashtu, legjislacioni i ndjeshëm nga perspektiva gjinore do të ketë ndikim në barazinë gjinore përmes politikave të rekrutimit të stafit akademik, avancimit profesional, qasjes në projekte studimore |

[1] ORGUT, Profili Gjinor i Kosovës 2014, faqe. 2, e qasshme nënhttps://www.womensnetwork.org/documents/20140513160130237.pdf.

| | |
|---|---|
| | dhe skema financimi të kërkimeve, përfaqësim në trupa vendim-marrës dhe udhëheqje të IAL. Për më shumë, legjislacioni do të ndikoj në ngushtimin e hendekut gjinor përmes adresimit të barrierave dhe pritjeve të diferencuara për gratë dhe burrat në Kosovë.<br><br>Në mënyrë që të rrisim nivelin e punësimit, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, Qeveria do të fokusohet në reformën dhe modernizimin e shërbimeve publike të punësimit nëpërmjet sigurimit të funksionalitetit të plotë të Agjencisë për Punësim të Republikës së Kosovës (APRK) dhe rritjes së kapaciteteve të saj për planifikimin, hartimin, zbatimin efektiv dhe monitorimin e masave aktive të tregut të punës. Gjithashtu, si pjesë e masave, do të zbatohet Plani i Veprimit për Adresimin e Papunësisë së të Rinjve. Mbështetje do të ofrohet edhe për praktikantët, iniciativat e punës vullnetare, vetëpunësimin dhe ndërmarrësin. Një numër në rritje e sipër i grave do të përfshihen në masat aktive të tregut të punës si dhe grupe të tjera të cenueshme dhe minoritare e vendit. |
| Ndikimet e barazisë sociale | Rregullimi i mëtejmë i fushës së akreditimit të programve të arsimit të lartë do të ketë ndikim të gjerë shoqëror: ekonomik, rajonal, përfishirjes sociale, qeverisje, kulturor dhe të sigurisë. Rritja e cilësisë në programe të studimit dhe ndërlidhja me tregun e punës, do të ndikoj në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Po ashtu, kjo do të ndikojë në konsolidimin e institucioneve të arsimit të lartë në konkurueshmëri të bazuar në standarde dhe cilësi në rekrutimin e stafit mësimdhënës. Së fundi, IAL-të do të mund të gjenerojnë të hyra përmes projekteve ndërkombëtare dhe kështu të shtojnë stafin përmes projekteve hulumtuese.<br>Ndikimi shoqëror shtrihet në Kosovë, por edhe jashtë Kosovës. Ndikimet rajonale janë të trefishta. Së pari ato ndërlidhen me tërhqjen e studentëve nga rajoni në programet e studimet e ofruara nga IAL-të në Kosovë. E dyta, në mobilitetin e stafit akademik dhe të diplomuarve në rajon si dhe punësimin. Dhe e treta, në bashkëpunimin në kërkime shkencore në nivel rajonal. Programe studime cilësore dhe të llojllojshme do të tërheqin studentë, jo vetëm nga qendrat e mëdha por nga tërë Kosova dhe rajoni, posaçërisht Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi.<br>Legjislacioni i avancuar në akreditim do të këtë ndikim pozitiv në përfshirjen sociale. Programet e studimit që shpiejnë në punësim do të zvogëlojnë papunësinë e të rinjëve dhe kështu edhe varfërinë.<br>Ndikimet në arsim kanë të bëjnë me lirinë akademike dhe qeverisjen e IAL-ve. Ligji do të fuqizoj më tej IAL-të në zhvillimin institucional dhe programeve të studimit; bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Ligji do të zgjeron spektrin e ndërveprimit e IAL-ve me 'hisedarët', studentët, organizata të shoqërisë civile dhe akterë tjerë vendor dhe ndërkombëtar. |

| | |
|---|---|
| | Ligji do të zgjerojë kulturën institucionale dhe arsimore në Kosovë. Do të ndikojë në promovimin e diversitetit kulturor përmes aktiviteteve që organizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete kulturore. Për më shumë, potenciali që do të ofron korniza ligjore do të mundëson IAL-të të zgjerojnë fushëveprimin në domene të gjera kulturore dhe të vendosin në qendër të dialogut dhe vlerave demokratike.<br>Konceptdokumenti parasheh një nga ndikimet shoqërore të ndërlidhet edhe me qeverisjen IAL-ve. Ligji do të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë qytetarëve në arsim përmes trajtimit të barabartë për të gjithë pa dallim; trajtimit të barabartë të studentëve stafit akademik dhe administrativ, pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje; ngritjen e transparencës në rekrutim dhe përfshirje në programe studimi dhe informimi e shoqërisë mbi programet e studimit, cilësisë, zhvillimin e karrierës dhe objektivat strategjike. Legjislacioni do të ketë ndikim edhe me ndërlidhjen e IAL-ve me organizatat e shoqërisë civile duke forcuar bashkëpunimin në interes të gjerë publik dhe zhvillim shoqëror.<br>Së fundi, këto ndikime në qeverisje do të ndikojnë që IAL-të të jenë institucione që veprojnë në bazë të rregullave formale dhe që adresojnë çdo praktikë joformale, korruptive dhe nepotiste. |
| Ndikimet tek të rinjtë | Duke u bazuar në numrin aktual të studentëve me mbi 100 000 studentë që ndjekin studimet në institucione të arsimit të lartë, ku për çdo vit akademik kemi mbi 20 000 studentë që synojnë të regjistrohen në IAL, ky është një tregues i qartë rreth rëndësisë së akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të cilat janë dhe ofrojnë sigurimin e cilësisë që shpie në studentë të kualifikuar, me shkathtësi dhe kompetenca për kualifikimin e tyre. |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Bazuar në nenin 31, pika 3 e UA për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28.09.2018), institucionet e arsimit të lartë obligohen që ti kryejnë obligimet e tyre financiare për marrje të akreditimit në shumat si në vijim:<br><br>1. Akreditimi fillestar institucional................................ 3 000 €<br>2. Riakreditimi institucional ......................................... 2 000 €<br>3. Akreditimi i programit të studimit ........................... 1 000 €<br>4. Riakreditimi i programit të studimit ........................... 500 €<br>5. Pagesa për një vlerësues të jashtëm (ekspert).......... 3 300 €<br>6. Pagesa për një vlerësues të jashtëm (student) ........ 2 400 €<br><br>Taksat administrative duhet të përmbushen sipas ciklit të akreditimit/riakredtimit në bazë të udhezimit administrativ 15/2018 |

| | |
|---|---|
| | dt.28.09.2018. |
| Ndikimi i NMV-ve | Nuk ka ndikime direkte |

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim). Ky opsion i këtij Konceptdokumenti nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës. Çdo aktivitet që lidhet me zbatimin e këtij legjislacioni është planifikuar në projeksionet buxhetore të MASHT-it, pasi vazhdohet me gjendjen aktuale, opsioni i propozuar mbulohet nga ndarjet e buxhetit në shumë prej €552,318 brenda kufirit aktual të MASHT-it.

Opsioni 2: Ndryshimi i qasjes ekzistuese nga gjendja aktuale në opsionin e dytë do të ketë implikime shtesë në Buxhetin e Kosovës. Për tu implementuar ky konceptdokument kushton në shumë prej 3,688,762 € (për pesë vite 2019-2023), ndërsa ndarja e mjeteve buxhetore për këtë konceptdokument është në shumë prej 2,839,930 € për vitet 2019 -2023, ndërsa kosto shtesë për implementimin e tij është në shuma prej prej 3,380,742.81 € për periudhën 2019-2023, të cilat mjete nuk janë të planifikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2023, draftbuxhetin 2019 dhe vlerësimet buxhetore 2020-2023 në MASHT.

Sipas analizave buxhetore opsioni i dytë ka implikime shtesë në buxhetin e Republikës së Kosovës në shumë prej 3,070,311€ për periudhën 2019-2023 (për vitin 2019 kostoja shtesë në shumë prej 840,786 € për vitin 2020 kostoja shtesë në shumë prej 834,822 €, si dhe për vitin 2021 kostoja shtesë në shumë prej 567,074 €, për vitin 2022 kosto shtesë në shumë prej 408,232 € dhe për vitin 2023 kosto shtesë është në shumë prej 419,396€ ). Kjo kosto shtesë nuk është e planifikuar në draftbuxhetin e vitit 2019 dhe vlerësimet buxhetore për vitet 2020-2023 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Opsioni 3: Ndryshimi i politikës ekzistuese (të bëhet diçka), ky opsion ka kosto shtesë në Buxhetin e Kosovës për vitin 2019 në shumë prej 86,274 euro, për hartim të bazës ligjore dhe zhvillimin e aktiviteteve që lidhet me zbatimin e këtij konceptdokumenti e të cilat mjete nuk janë të planifikuara në draftbuxhetin e vitit 2019 dhe vlerësimet 2020-2021 në MASHT.

Ndryshimi i qasjes së zbatimit të legjislacionit aktual mes akterëve si AKA, MASHT, dhe gjithë të tjerëve, apo edhe rritja e numrit të stafit duke kërkuar nga Qeveria/Ministria e Financave dhe Administratës publike në kuptimin që do të forcoheshin burimet njerëzore në AKA dhe ngritja e buxhetit, por edhe kjo prap nuk është opcion i mjaftueshem për adresimin e problemeve sepse nuk siguron qëllimin kryesor të pavarësisë së AKA. Andaj rekomandohet opcioni 2 për nxjerrjen e ligjit për AKA ku siq kemi cekur edhe nga problemet e mësiperme ku ndryshimi i shpeshtë i akteve nënligjore na sjell vështirësi implementuese të politikave. Gjithashtu shkakton konfuzitet tek IAL nxjerrja e akteve dhe plotësim ndryshimeve në raport me kërkesat e akreditimit dhe zbatimit të këtyre akteve.

Tabela1: Paraqet një përmbledhje të 3 opsioneve të mundshme lidhur me ndikimet buxhetore

| Përmbledhje e Vlerësimit të ndikimit financiar | Buxheti i vitit aktual 2018 | Opsioni 1 vazhdimi i gjendjes aktuale | Opsioni i dytë të ndryshimi i gjendjes aktuale | Diferenca ndërmjet opsionit 1 dhe 3 | Opsioni i tretë të ndryshimi i gjendjes aktuale | Diferenca ndërmjet opsionit 1 dhe 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Totali i opsioneve - si pas kategorive ekonomike | 500,489 | 552,318 | 1,237,312 | (684,994) | 638,592 | (86,274) |
| Stafi | 9 | 13 | 32 | (19) | 13 | - |
| Paga dhe mëditje | 73,667 | 125,496 | 300,490 | (174,994) | 131,770 | (6,274) |
| Mallra dhe shërbime | 426,822 | 426,822 | 426,822 | - | 496,822 | 70,000 |
| Shpenzime komunale | | | 10,000 | (10,000) | 10,000 | (10000) |
| Shpenzime kapitale | | | 500,000 | (500,000) | | - |

Tabela 2: Paraqet një përmbledhje për pesë vitet 2019-2023 të kostos totale dhe diferencën

| Përmbledhje e Vlerësimit të ndikimit financiar | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Opsioni 2 | 1,393,104 | 1,403,414 | 1,132,255 | 986,305 | 995,164 | AKA |
| Paga dhe mëditje | 366,342 | 368,174 | 370,015 | 371,865 | 373,724 | AKA |
| Mallra dhe shërbime | 516,762 | 525,240 | 532,240 | 554,440 | 581,440 | AKA |
| Shpenzime | | | | | | AK |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| komunale | 10,000 | 10,000 | 30,000 | 40,000 | 40,000 | A |
| Shpenzime kapitale | 500,000 | 500,000 | 200,000 | 20,000 | | AKA |

Tabela 3: Paraqet një përmbledhje të implikimeve buxhetore për pesë vite 2019-2023 (kosto shtesë për pesë vite)

| Përmbledhje e Vlerësimit të ndikimit financiar | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Opsioni 2** | 840,786 | 834,822 | 567,074 | 408,232 | 419,396 | AKA |
| Paga dhe mëditje | 240,846.00 | 236,403.71 | 231,656.08 | 232,814 | 233,978 | AKA |
| Mallra dhe shërbime | 89,940.00 | 98,418.00 | 105,418.00 | 115,418.00 | 115,418.00 | AKA |
| Shpenzime komunale | 10,000.00 | 0.00 | 30,000.00 | 40,000 | 70,000 | AKA |
| Shpenzime kapitale | 500,000.00 | 500,000.00 | 200,000.00 | 20,000 | 0 | AKA |

